

KOSOVA  
NË SHTENDOSJEN E RAPORTEVE  
SHQIPTARO-JUGOSLLAVE NË VITET '60-70

ETHEM ÇEKU\*

(*Abstrakt*) Objekt i studimit tonë është Kosova në raportet shqiptaro-jugosllave në vitet '60-'70, një periudhë kjo e ngritjes së institucioneve autonome të Kosovës. Studimi është përgatitur duke u mbështetur në analizat e gjertanishme të shkencës historike shqiptare, serbe dhe ndërkombëtare, si dhe në dokumentet më të reja të proveniencës amerikane, ruse, serbe dhe shqiptare. Dijsa e gjertanishme e studimeve shqiptare këto marrëdhënie i sheh si ndikim i raporteve ndërkombëtare, në veçanti brenda dy kampeve të Lindjes dhe të Perëndimit, por edhe me ndryshimet brenda shtetit jugosllav. Brenda këtyre zhvillimeve gjeti interesat e saj politike edhe shteti shqiptar. Pavarësisht nga dokumentet anësore që dalin, zhvillimet e brendshme në Kosovë dhe më gjerë, vlerësimet politike dhe ato kulturore e shkencore që promovohen nga Tirana në Prishtinë, dëshmojnë se në esencën e tyre ato përvijoheshin nga paradigma nacionale. Kjo ndërkaq nuk e pengonte as palën shqiptare as atë jugosllave që këto aktivitete të mos i përdornin për propagandë ndërkombëtare: fqinjësinë e mirë (shqiptarët) dhe avancimin politik e kulturor të pakicave (jugosllavët). Në të vërtetë, më shumë se njëra apo pala tjetër, nga kjo përfituan shqiptarët në Kosovë, jo vetëm në ngritjen e institucioneve të tyre politike, ekonomike, arsimore, kulturore e sociale, por edhe për fuqizimin e frymës kombëtare, e cila do të shpërthente në vitin 1981, një Lëvizje kjo e cila do ta parapërgatiste krizën dhe rrëzimin përfundimtar të federatës jugosllave.

*Fjalët nyje:* Kosova, Shqipëria, Jugosllavia, marrëdhëniet ndërkombëtare, statuti politik, ekonomik, arsimor dhe kulturor, shqiptarët

*SKICA TË ARTIKULLIT*

Raportet shqiptaro-jugosllave në kontekst të raporteve ndërkombëtare  
Kërkesa për Republikën e Kosovës dhe qëndrimi i Shqipërisë  
Hezitimi i Shqipërisë ndaj veprimtarisë së Lëvizjes nacionale në Kosovë  
Qëndrimi i Shqipërisë ndaj ngjarjeve në Jugosllavi në fillim të viteve '70  
Kosova në luftën ideologjike të Shqipërisë  
Qëndrimet e Enver Hoxhës dhe Fadil Hoxhës rreth çështjes së Kosovës në vitet '70

\*

*Parathënie*

Konflikti mes Titos dhe Rankoviçit dhe humbja e këtij të fundit, ndikoi në krijimin e një klime më liberale në jetën politike në Jugosllavi. Kjo klimë në mënyrë të veçantë u shpreh me krijimin e institucioneve

---

\* Bio: Prof. dr. Ethem Çeku, ka lindur në Pejë më 01 tetor të vitit 1962. Ka mbaruar studimet në *Universitetin e Prishtinës*, Fakulteti Filozofik në vitin 1989. Në vitin 2003 në të njëjtin fakultet merr gradën shkencore magjistër. Një magjistraturë të dytë merr në vitin 2009 në *Universitetin për Biznes dhe Teknologji në Prishtinë*. Ka doktoruar në vitin 2009 *Universitetin e Prishtinës*, Fakulteti Filozofik duke fituar thirrjen shkencore: "Doktor i shkencave të historisë." Po në vitin 2009 merr titullin tjetër: "Profesor asistent." Në vitet 1999-2000 ka qenë kryetar i Komunës së Pejës, ndërsa në vitet 2002-2004 ka qenë Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kurse në vitet 2004-2007 ka qenë Ministër i Energjetikës dhe Minierave, ndërsa në vitet 2007-2011 ka qenë Zëvendës-kryetar i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Tregëti, Energji dhe Miniera. Nga viti 2012 e sot është dekan i Fakulteti i Edukimit në *Universitetin e Prishtinës*.

politike të Kosovës. Pas Plenumit të IV të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, të njohur si Plenumi i Brioneve, më 1 korrik 1966<sup>1</sup> dhe nën tryshinë e madhe të forcave progresive vendore e ndërkombëtare, Titoja ishte i detyruar të bënte disa lëshime në favor të Kosovës. Sikur shprehej studiuesi Noel Mallkolm gjatë kësaj kohe pasun lëshime të llojllojshme për shqiptarët. Në mars të vitit 1967, Titoja vizitoi Kosovën pas 16 vitesh; këtë herë ai bëri kritikë publike për kushtet në Kosovë: “Nuk mund të flitet për të drejta të barabarta”, deklaroi ai, “kur serbët kanë përparësi kudo nëpër fabrika... kurse shqiptarët refuzohen edhe pse kanë kualifikime të njëjta apo edhe më të larta”<sup>2</sup>. Brenda pak vitesh pas këtij Plenumi u themelua Universiteti i Prishtinës (1970), i cili do të bëhej bazë e fuqishme për lëvizjen patriotike shqiptare; në administratën shtetërore filloi punësimi më i madh i qytetarëve shqiptarë; në organet shtetërore, edhe pse në mënyrë të ngadalësuar, filloi të vendosej kuadri i shkolluar shqiptar. Në fushë të ekonomisë u bënë disa investime në industrinë bazike, posaçërisht në sektorin energjetik dhe atë minerar, në sektorin e bujqësisë dhe në infrastrukturën rrugore<sup>3</sup>.

Kjo është arsyeja pse disa nga historianët shqiptarë dhe të huaj, në analizat e tyre theksojnë se këto vite paraqesin një progres në lëmin e ekonomisë, të administratës, të kulturës e të arsimit, e kjo do të thotë në të gjitha sistemet politike, ekonomike e sociale, të cilat e përmirësuan jetën e popullatës së kësaj njësie politike të federatës jugosllave ku mbi 90% e saj ishin të etnisë shqiptare. Mirëpo, me gjithë investimet e bëra, Kosova edhe më tutje mbeti një nga rajonet më të prapambetura të federatës jugosllave<sup>4</sup>, sado studiuesit serbë edhe më tej mendojnë se pikërisht këto ndryshime kushtetuese përshpejtuan krizën e madhe ekonomike dhe politike jugosllave.<sup>5</sup> Një ndryshim kualitativ, ndërkaq, ndodhi me ngritjen e pozitës kushtetuese të Kosovës.<sup>6</sup>

### *Raportet shqiptaro-jugosllave në kontekst të raporteve ndërkombëtare*

Në këtë periudhë filloi një raport i ri mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, filloi procesi i shtendosjeve të raporteve shqiptaro-jugosllave. Kjo shtendosje vinte më tepër si rrjedhojë e ndryshimeve të mëdha politike vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe kërkimit të ndërtimit të raporteve të reja mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Historiani Hamit Kaba, duke i pasqyruar refleksionet e marrëdhënies me SHqipërisë dhe BRSS dhe ato mes Shqipërisë dhe SHBA-ve, në vitet 60 theksonte se “kthesat që ndodhën në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike, pas mbledhjes së Bukureshtit, që u mbajt më 24 qershor 1960, duhet thënë se ishin të papritura për udhëheqjen sovjetike (...). Mosmarrëveshjet shqiptaro-sovjetike, pas fazës disavjeçare të inkubacionit u bënë publike në nëntor të vitit 1960<sup>7</sup>. Shqipëria iu afrua Kinës dhe ndërpreu çdo lidhje me Bashkimin Sovjetik, në vitin 1961. Duke pasqyruar pozitën e Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet ‘60 Kaba shprehet: “Marrëdhëniet me SHBA-të vijuan të mbeten të ndara. Nuk pati ndonjë përpjekje serioze për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve (...). Në fillim të viteve ‘60 politika e jashtme e shtetit shqiptar ishte krejt e pabalancuar. Ndërrerja e marrëdhënies me BRSS-në, lidhjet jonormale me vendet fqinje ballkanike, qëndrimi armiqësor ndaj SHBA-ve, indiferente ndaj Italisë dhe Francës.”<sup>8</sup> Pika kulmore e konfliktit shqiptaro-sovjetik u arrit në nëntor të vitit 1960, në Konferencën e Moskës, ku udhëheqësit shqiptarë, Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Hysni Kapo dhe Ramiz Alia, ngritën akuza të rënda kundër politikës së Hrushovit. Më 16 nëntor 1960, Enver Hoxha akuzoi BRSS-në për nxitjen e një revolucioni antikomunist në Shqipëri dhe si përkrahëse e pretendimeve greke ndaj Shqipërisë së jugut.

Lidhur me këtë studiuesi Beqir Meta kishte vërejtur se Hrushovi dhe udhëheqja sovjetike ishin të gatshëm të merrnin parasysh pretendimet e Greqisë ndaj Shqipërisë, po që se kjo e fundit do të afrohej me politikën e BRSS-së.<sup>9</sup> Në qershor të vitit 1961 sovjetikët filluan të largoheshin nga baza e Vlorës<sup>10</sup>. Kina dëshironte që

<sup>1</sup> Branko Petranović & Momčilo Zečević, *Jugoslavija 1918-1984*. Zbirka dokumenata. RAD. /Rezolucija Informacionog Biroa Komunističke Partije o stanju u KPJ, 28 juni 1948/. Beograd, 1985, 942-947.

<sup>2</sup> Noel Malcolm, *Kosova – një histori e shkurtër*. (Përktheu nga anglishtja dr. Abdullah Karjagdiu, ripunuar nga Piro Misha. Botim i dytë). Prishtinë-Tiranë: Koha & Shtëpia e librit, 2001, 332.

<sup>3</sup> Xhelal Gjeļovi (red. shk.) *Historia e popullit shqiptar (1939-1990) IV*, Botimet Toena, Tiranë 2008, 348-356

<sup>4</sup> Ismet Gusia, *Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës*, Prishtinë, 1982; Marenglen Verli, *Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*, Tiranë, 2000; Branko Horvat, *Kosovsko pitanje*, Globus, Zagreb, 1987; Mishel Ru, *Kosova një zhvillim ekonomik i ngadalshëm dhe i pamjaftueshëm*, “Herodote”, maj-korrik, Tuluz Francë, 1982, cit. sipas vëllimit “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, ASH e RPSSH, Tiranë, 1990, 459-476.

<sup>5</sup> Dragutin V. Marseniq, *Ekonomika Jugosllavije*, Beograd, 2000, 213-218.

<sup>6</sup> N. Mallkom, *vep. e cit.*, 327-347; Luan Omari, *Ndryshimet kushtetuese dhe autonomia e Kosovës*, në vëllimin: “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, ASH e RPSSH, Tiranë, 1990, 520-545.

<sup>7</sup> Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e luftës së ftohtë*. Tiranë: Botimpex, 2007, 164.

<sup>8</sup> H. Kaba, *vep. cit.*, 165.

<sup>9</sup> Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia 1949-1990. Paqja e Vështirë*. Tiranë: Koçi, 2004, 165-206.

në këtë kohë të shtrijë ndikimin e saj në Evropën Lindore dhe pikërisht Ballkani ishte një pikë mbështetëse për të. Për këtë arsye Kina dëshironte që Shqipëria të ketë marrëdhënie diplomatike të mira me Jugosllavinë. Të gjitha dokumentet arkivore tregojnë që kinezët bënë presion të jashtëzakonshëm tek Shqipëria që të arrijë një raport të tillë.<sup>11</sup> Prandaj, në fillim të viteve '60 nis periudha e shtendosjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, të shoqëruara me deklarata për mbështetje në rast të ndonjë agresioni.

Hrushovi bënte përpjekje për ta izoluar Shqipërinë, duke e kërkuar edhe mbështetjen e Jugosllavisë dhe njëkohësisht në strategjinë e tij politike ishte analizuar mundësia e përdorimit të elementeve antienveristë në Shqipëri dhe në Kosovë për ta rrëzuar Enver Hoxhën nga pushteti. Ja se ç'thuhet në një dokument të Departamentit të Shtetit Amerikan, i cili pasqyron bisedën mes këshilltarit të ambasadës jugosllave Ruzhiq me përfaqësuesin amerikan Robert C. Mud, më 2 shkurt 1962: "Sovjetët i kanë kërkuar jugosllavëve të bashkohen me ta kundër Shqipërisë. Bullgarët kanë bërë të njëjtin propozim me zyrtarët jugosllavë (...) Jugosllavët janë interesuar për vazhdimin e paqes dhe qëndrueshmërisë në Ballkan dhe për këtë arsye i hodhën poshtë propozimet sovjetike e bullgare."<sup>12</sup>

Kosova ishte parë vazhdimisht si potencial antikomunist nga Jugosllavia dhe si levë e fuqishme për rrëzimin e regjimit të Enver Hoxhës. Është fakt se në tokat shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia nuk ishte pranuar asgjë ideologjike që vinte nga Beogradi dhe nga Moska. Prandaj ideologjia komuniste e bartur përmes Beogradit, që ishte simbol i represionit dhe shtypjes nuk arriti të gjejë mbështetje të popullata shqiptare nën Jugosllavi. Edhe ftesa e PKJ-së për t'u radhitur shqiptarët në luftë të përbashkët me ta nuk kishte gjetur ndonjë përkrahje.<sup>13</sup> Kjo dëshmon se fryma e Lëvizjes politike kombëtare e shqiptarëve nën Jugosllavi për bashkimin kombëtar nuk ishte shuar asnjëherë, asnjëherë pavarësisht nga presioni i madh që ishte bërë në të gjitha format e regjimeve të pushteteve jugosllave<sup>14</sup>. Po ashtu përpjekjet e vazhdueshme të shtetit jugosllav për t'i nxitur shqiptarët nën Jugosllavi kundër Shqipërisë, asnjëherë nuk kishin rezultuar me sukses. Prandaj, "Jugosllavët besojnë se Hoxha e kishte nën kontroll të plotë Shqipërinë. Hoxha dhe klika e tij dyshojnë në gegët dhe i vëzhgojnë me kujdes të veçantë. Shumica e shqiptarëve në Kosmet janë gegë, prej këndeje potencialet anti-Hoxhë të Jugosllavisë në Shqipëri janë të kufizuara", thuhet në raportin për Departamentin e Shtetit Amerikan.<sup>15</sup>

Në të njëjtën kohë Enver Hoxha, gjatë gjithë kohës, do të tregohej tepër i kujdesshëm dhe i matur me Kosovën. Ishte krijuar frika se Jugosllavia do t'i përdorte Kosovën dhe shqiptarët nën Jugosllavi, për ta rrëzuar nga pushteti. Për ngjarjet e viteve që do të pasojnë, sidomos demonstratat e vitit 1968, politika e shtetit shqiptar ishte shumë e tërhequr dhe e frikësuar nga qëllimet e tyre. Në dokumentin e lartcekur: "Rusët gjithsesi vazhdojnë të besojnë se mund ta rrëzojnë Hoxhën nga pushteti. Jugosllavët nuk besojnë se rusët mund të paktën edhe për disa kohë. Jugosllavët dhe grekët janë në marrëveshje se politika më e mirë kundrejt Shqipërisë tash për tash është *duart larg*"<sup>16</sup>.

Vitet e shtendosjes së raporteve diplomatike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë për shqiptarët e pushtuar nga Jugosllavia, paraqesin një fazë të re zhvillimi mbi të cilën do të krijohen hapësira politike më të favorshme për veprim.

Në këtë periudhë, Lëvizjes patriotike shqiptare iu kishin krijuar hapësira më të favorshme veprimi, prandaj ajo nga strukturat e vogla dhe jo shumë të fuqishme, shtroi para vetes detyra për të kaluar në një shkallë shumë më mirë të organizimit. Ndër detyrat e saj madje ajo konkretizoi një nga aktivitetet më të rëndësishme të veprimit: masovizimin e koncepteve politike të saj, sidomos tek rinia dhe tek studentët<sup>17</sup>. Ajo tani ishte në fazën e fuqizimit të saj, në atë të kalimit nga organizimi në grupe drejt organizimit në lëvizje apo në parti. Ajo, gjithashtu, arriti që në këtë kohë të nxjerrë edhe shtypin e vet periodik, të organizohet

<sup>10</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*. Tiranë: Kristalina KH, 2007, 273-274.

<sup>11</sup> "National Archives and Record Administration of United States of America." Airgram i Ambasadës amerikane në Paris për Departamentin e Shtetit, më 21 tetor 1968, lidhur me marrëdhëniet shqiptaro-kineze; Enver Hoxha, *Ditari politik për çështje ndërkombëtare 1970-1971. (Për përdorim të brendshëm)*, Tiranë, 432. Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Shb Kartë e pendë, Tiranë, 1995, 522-523.

<sup>12</sup> *United States National Archives*. (Henceforth: USNA) 767.00/2-262. Memorandumi i bisedës s[ këshilltarit politik të Ambasadës jugosllave në SHBA, me përfaqësuesin e Departamentit të Shtetit, më 2 shkurt 1962, 1-5.

<sup>13</sup> Xh. Gjeçovi, vep. cit., 129-133.

<sup>14</sup> *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*. Tiranë: Akademia e Shkencave, Arkiva Shtetërore, Instituti i Historisë, 2004; *Vendimet e Konferencës së Bujanit*. Prishtinë: ASHAK, 2005.

<sup>15</sup> USNA, 767.00/2-262, 1-5.

<sup>16</sup> Ibid.

<sup>17</sup> Ethem Çeku, *Struktura politike e ilegales së Kosovës*. Tiranë, 2006; Ibid. *Struktura politike e ilegales së Kosovës. Brezi '81 (Political structure of the illegality of Kosovo. Generation 81)*. Prishtinë, 2006.

shumë më fuqishëm në diasporë dhe të vendos kontakte të rëndësishme me institucionet ndërkombëtare, që mbështesnin luftën e popullit shqiptar për çlirimin e tij.<sup>18</sup>

Lëvizja nacionale, duke fituar përvoja nga lufta e vazhdueshme që zhvillonin forcat demokratike të kohës, arriti ta shtronte, mundësinë e daljes publike të kërkesave të saj rreth rregullim të ri kushtetues-juridik të Kosovës, përkatësisht për ngritjen e statusit politik të saj.

Ishte hera e parë, që nga Luftës së Dytë Botërore, të shtrohej çështja e Republikës së Kosovës. Në këtë kohë, kjo kërkesë për pozicionin e ri kushtetues-juridik të Kosovës u paraqit në mënyrë të hapur dhe me më pak presione dhe kundërshtime të dhunshme shtetërore.

Po ashtu edhe udhëheqja politike kosovare, edhe pse ishte në një vartësi politike dhe përgjegjëse ndaj udhëheqjes politike serbe dhe jugosllave, ishte e pakënaqur me pozitën kushtetuese-juridike të Kosovës<sup>19</sup>. Në këtë kohë në nivelin e federates ishte shtruar nevoja për fillimin e një procesi të ri për ndryshime kushtetutare në të gjitha nivelet e shtetit jugosllav. E gjendur nën presionin e madh të ngjarjeve të brendshme dhe të jashtme, të kërkesave të vazhdueshme nga të gjitha shtresat e shoqërisë kosovare, e në veçanti të Lëvizjes nacionale, në vitin 1968 u formua Komisioni për ndryshimet kushtetuese në Kosovë, kryetar i të cilit u emërua ish komandanti i Forcave Ushtrake Partizane gjatë Luftës së Dytë Botërore Fadil Hoxha.

Diskutimet kushtetuese filluan, së pari, në disa qendra të mëdha. Kështu, më 16 gusht 1968, në aktivin politik të Gjakovës, një nga qytetet me një strukturë të pasur intelektualësh dhe komunistësh që nga Lufta e Dytë Botërore, prej nga vinin gjithashtu edhe pjesa më e madhe e strukturave politike-shtetërore të Kosovës në kryeqytetin e saj Prishtinë: “1. Në kushtetutën e RSFJ-së, kombësia shqiptare të emërohet si komb; 2. Me kushtetutë dhe ligj të përcaktohet përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar; 3. Krahina e Kosovës të shpallet Republikë e Kosovës. Qëndrimi i aktivitetit të Gjakovës pothuajse unanimisht u përkrah nga Aktivitë politikë të Prishtinës, Gjilanit, Pejës dhe Mitrovicës”<sup>20</sup>. Këto diskutime të bëra në instancat politike të institucioneve të Kosovës, bënë që një numër i konsiderueshëm i intelektualëve si: Fehmi Agani, Gazmend Zajmi, Ali Hadri, Dervish Rozhaja, Bardhyl Çausi, Mark Krasniqi, Rrezak Shala, Ramadan Vraniqi, Hajredin Hoxha e Syrja Pupovci, të përkrahnin dhe mbështetnin kërkesën për Republikën e Kosovës.<sup>21</sup>

Po në këtë kohë u zhvilluan diskutime edhe brenda strukturës së lëvizjes politike kombëtare mbi formësimin e platformës politike, se me çfarë kërkesash duhej të dilej në raport me faktorin jugosllav dhe faktorin ndërkombëtar. Ishin krijuar tri opsione politike: 1. Bashkimi me Shqipërinë, 2. Bashkimi i tokave shqiptare në Jugosllavi në një republikë, në kuadër të federatës jugosllave dhe 3. Republika e Kosovës. Çështja e shtruar kishte të bënte me dilemën, nëse kërkesa për Kosovën Republikë cënonte apo devijonte idenë e bashkimit të tokave shqiptare me shtetin amë, Shqipërinë, siç ishte parashikuar në Programin e Nacional Demokratikes Shqiptare<sup>22</sup>, apo nga programi politik dhe kombëtar i Adem Demaçit dhe ai i Metush Krasniqit<sup>23</sup>. Në programin politik të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, të hartuar nga Adem Demaçi me patriotët e tjerë, në nenin 1 të tij, thuhej: “Qëllimi i parë dhe i fundit, i lëvizjes sonë asht sigurimi i të drejtës për vetëvendosje, deri në shkëputje për viset e banueme me shumicë prej shqiptarëve, që gjinden ende nën administrimin e Jugosllavisë, domethanë qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë, asht çlirimi i krahinave shqiptare të aneksueme prej Jugosllavisë dhe bashkimi këtyne krahinave me nanën e vet Shqipërinë.”<sup>24</sup>

Duke qenë të bindur thellë, për shkak të përvojës së hidhur nga e kaluara, që klasa politike jugosllave nuk do të ofronte zgjidhjen e çështjes nacionale në Kosovë, e cila do të ishte në përputhshmëri me kërkesat e shqiptarëve, forcat nacionale patriotike kishin arritur të sublimojnë veprimin e tyre politik me organizimin e

<sup>18</sup> Shih, monografinë Ethem Çeku, *Struktura politike e ilegales së Kosovës*, Tiranë, 2006, ku janë diskutuar gjerësisht aktivitetet e Lëvizjes patriotike të shqiptarëve në Jugosllavi mbështetur në dokumentet e provinencës jugosllave dhe arkivit të Lësvizjes.

<sup>19</sup> Arkivi i Kosovës, Fondi Komiteti Krahinor i LK të Serbisë për Kosovë e Metohi, g. 3, k 2a/40, viti 1967, (Razgovor presednika Savezne Skupstine E. Kardelja sa delegacijom Autonomne Pokrajine Kosova i Metohije, održan 21 marta 1967, godine, stenografike beleške).

<sup>20</sup> Dokument nga Arkivi i Kosovës, Buletini informativ, Prishtinë, shtator 1968. Çështja e flamurit kombëtar ishte bërë simbol i lëvizjes politike të shqiptarëve në Jugosllavi, për realizimin e të drejtave të tyre kombëtare. Gjenerata të tëra të Lëvizjes politike nacionale kishin vendosur me fanatizëm për ta mbrojtur dhe për ta legalizuar përdorimin e flamurit kombëtar.

<sup>21</sup> Mallkom, vep., cit. 327-347.

<sup>22</sup> Arkivi i Kosovës, Prokuroria Publike e Kosovës dhe Metohisë, K. Nr. 99/45, 11 shtator 1945, Gjyqi Krahinuer i Kosovës dhe Metohisë, Prizren, pretendencë kundër Halim Spahisë dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Qendror të Organizatës Nacional Demokratike.

<sup>23</sup> Arkivi i Kosovës, Gjykata e Qarkut në Gjilan, K.nr. 19/59, Aktgjykimi kundër Metush Krasniqit dhe anëtarëve të tjerë të Parisë Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë.

<sup>24</sup> Arkivi i Kosovës, Fondi; Gjyqi i Qarkut Prishtinë, nga Programi i LRBSH-së tek Dosja Demaçi.

demonstratave në nëntor të vitit 1968, me ç'rast ata bënë publike qëndrimet dhe kërkesat e tyre politike dhe kombëtare.<sup>25</sup>

Fillimi i viteve '70 sërish sjellë një klimë pozitive të shtendosjes së marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi. Kjo klimë del në pah edhe në bisedën e zhvilluar më 24 gusht 1973, në pritjen që i bëri zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, Adil Çarçani, kryetarit të Këshillit Ekzekutiv të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës Ilia Vakiqit dhe ambasadorit të RSFJ-në në Shqipëri Jovan Pejçinoviqit. Adil Çarçani, me këtë rast kishte thënë: "Të dy popujt tanë kanë qenë dhe janë për paqe, ata kanë luftuar për shekuj me radhë për mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë së tyre... Është me interesin e dy popujve tanë që ndërmjet nesh të ketë miqësi, paqe e jo luftë dhe të zhvillojmë marrëdhëniet mbi baza të drejta. Kjo është dëshirë jo vetëm e popullit, por edhe qeveria jonë ka deklaruar kurdoherë që ne jemi me popullin jugosllav dhe dëshirojmë që Jugosllavia të jetë e fortë dhe independence (...) Shoku Enver ka deklaruar se në qoftë se do të preket independence e popullit jugosllav populli shqiptar do të jetë me të e do ta ndihmojë për ta mbrojtur atë dhe veten e tij. Pra, na takon të gjithëve e në mënyrë të veçantë diplomatëve që ta zbatojmë këtë politikë të drejtë."<sup>26</sup>

Tashmë Shqipëria dhe Jugosllavia kishin arritur disa marrëveshje të rëndësishme në fushën e arsimit, të ekonomisë, të këmbimeve shkencore dhe në disa fusha të tjera. Në këto vite Shqipëria kishte angazhuar një masë të madhe njerëz nga shkenca dhe kultura për të ndihmuar që në Kosovë të arrihet një progres më i madh edukativ. Prandaj që nga viti 1968 dhe deri në mars të vitit 1981 kishte një kualitet të marrëdhënieve të mira mes dy vendeve e posaçërisht, mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Gjatë periudhës së aprovimit të amendamenteve kushtetuese në Kosovë, Shqipëria përcille me vëmendje këto procese, duke marrë qëndrim të hapur për mbështetjen e tyre. Në një dokument të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, të vitit 1972, duke i përcaktuar detyrat për Kosovën, për periudhën e vitit 1973, në mes të tjerash, thuhet: "Të ndiqen me kujdes të veçantë diskutimet për aprovimin e amendamenteve të reja të kushtetutës së Kosovës dhe të inkurajohen kosovarët në luftën e tyre për realizimin e të drejtave kushtetuese për të mos u tërhequr asnjëherë nga rrethanat ose ndikimet e rastit"<sup>27</sup>.

Në këtë fazë të marrëdhënieve politike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Shqipëria ishte tepër e kujdesshme që këto marrëdhënie t'i forconte edhe më tutje, për t'i shtendosur raportet mes dy vendeve, për ta shfrytëzuar këtë formë të veprimit, që Kosova të kishte mundësinë për të fituar sa më shumë të drejta juridike në kuadrin federatës jugosllave. Prandaj, Shqipëria në këtë kohë bëri manovra politike për t'i "arnuar" marrëdhëniet me jugosllavët<sup>28</sup> edhe pse, sikur thuhet në një letrat e ambasadorit jugosllav në Tiranë, më 1980: "Shqipëria, në aspektin arsimor, shkencor, kulturor dhe sportiv, është më e gatshme të bashkëpunojë me një fshat të banuar me shqiptarë kudo në Jugosllavi, se sa me një republikë a krahinë jugosllave ku nuk ka popullsi shqiptare"<sup>29</sup>.

Prandaj, shtendosja e raporteve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë ndikoi që lëvizja politike në Kosovë të shtrojë platformën e saj politike dhe të arrijë që Kosova ta ketë një avancim më të lartë kushtetutar.

### *Qëndrimi i Shqipërisë ndaj lëvizjes politike në Kosovë në vitet '60*

Shqipëria në fillim të viteve '60 ishte më aktive rreth çështjes së Kosovës. Ajo tanimë kishte shtruar si platformë politike brenda institucioneve politike dhe shtetërore detyrat për t'u marrë me çështjen e Kosovës. Zhvillimet që po ndodhnin në Kosovë, kërkesat e vazhdueshme nga lëvizja ilegale drejtuar shtetit shqiptar për mbështetje të saj, e shtynë Shqipërinë që të ndërtojë një strategji të veprimit, e cila nuk dallohej shumë nga vitet e kaluara dhe nga fryma e veprimeve në baza ideologjike, por tani këtë mbështetje e gjejmë shumë më të sistemuar dhe të organizuar nga organet shtetërore.

Edhe pse në një situatë të raporteve të acaruar ndërkombëtare, kur presioni ndaj saj ishte shtuar për të vendosur marrëdhëniet dhe për të pranuar pakte dhe paqe në Ballkan, ajo mbeti konsekuente në veprimet e saja në raport me çështjen e Kosovës. Tani ajo ndryshoi formën e veprimit, duke u futur më thellë në dhënien e udhëzimeve, por dhe në kritikën e hapura për lëvizjen politike ilegale në Kosovë, që në disa raste e shohim se Enver Hoxha kishte gabuar në krijimin e koncepteve dhe aleancave për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

<sup>25</sup> Gjykata e Qarkut Prishtinë, Aktgjykimi kundër Osman Dumoshit dhe anëtarëve të tjerë të Grupit të të rinjve të LRBSH-së, 7 prill 1969.

<sup>26</sup> AQSH, fondi 890, 1973, dosja 230, 54.

<sup>27</sup> AMPJ, Viti 1972, Dosja b8/2, nr. 636, 10.

<sup>28</sup> AMPJ, 1970, Dosja b7/2d, nr. 581, 7.

<sup>29</sup> Begzad Baliu, *Marrëdhëniet arsimore dhe shkencore jugosllavo-shqiptare në prag të demonstratave të vitit 1981*. Konferenca: *Demonstratat e vitit 1981*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2011, 14.

Prandaj, kjo periudhë karakterizohet nga intensiteti i marrëdhënieve të PPSH-së me grupet politike shqiptare në emigracion dhe brenda në Kosovë. Megjithëse marrëdhëniet, informacionet, udhëzimet ishin të karakterit “tepër sekret” dhe thuajse ilegale me grupet dhe organizatat politike shqiptare në mërgim, strukturat ndërlidhëse të shtetit shqiptar ishin zgjeruar dhe drejtimet e punës ishin të shumta. Ne po ndalemi në disa prej tyre:

1. Përfaqësitë diplomatike të shtetit shqiptar një ndër funksionet prioritare kishin ndërlidhjen, orientimin dhe organizimin me strukturat politike të shqiptarëve të Kosovës në mërgim<sup>30</sup>;

2. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme funksiononte një drejtori e posaçme që ndiqte nga afër zhvillimet politike në Kosovë dhe politikën e Beogradit ndaj Kosovës. Kjo drejtori përgatiste për KQ të PPSH-së buletin periodik informativ për Kosovën me karakter “tepër sekret”<sup>31</sup>;

3. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme funksiononte drejtorja e posaçme, e cila me strukturat e organizuara hynte në lidhje e marrëdhënie me grupet politike të shqiptarëve të Kosovës brenda në Kosovë dhe në përfundim për të njohur nga afër gjendjen dhe depërtimet në to të agjencisë jugosllave<sup>32</sup>.

4. Në KQ të PPSH-së funksiononte sektori i posaçëm me emërtimin “Sektori i Kosovës” me këto detyra:

a) të ndiqte gjendjen politike veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të organizatave shoqërore-politike, marrëdhëniet me strukturën nacionale në Kosovë e në viset e tjera shqiptare nën Jugosllavi, që lidhen e ndikojnë në gjendjen kombëtar të shqiptarëve në Jugosllavi.

b) të njëjtte politikën nacional-shoviniste që zbatohet në fushën ekonomike dhe nivelin e jetesës e gjendjes ekonomike të popullsisë shqiptare nën Jugosllavi;

c) të ndiqte gjendjen arsimore e kulturore të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, politikën që zbatohet në këtë fushë, veprimtarinë e institucioneve shkencore dhe letërsinë, artet, kinematografinë etj.;

ç) të ndiqte gjendjen e veprimtarinë e emigracionit ekonomik dhe politik kosovar, të organizatave patriotike dhe revolucionare, e parë kjo në lidhje të ngushtë me qëndresën dhe realizimin e kërkesave të popullit të Kosovës në rrugë demokratike;

d) në bashkëpunim me sektorë të tjerë të KQ –së do të ndihmonte në përpunimin dhe kontrollin e zbatimit të orientimeve të partisë dhe detyrat që kishin institucionet e ndryshme në drejtim të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi;

dh) të mbante lidhje e të ndiqte problemet që kishte Ministria e Jashtme dhe ajo e Punëve të Brendshme për ato çështje që lidheshin me detyrat funksionale të shtetit;

e) të mbante lidhje e të bashkëpunonte me institucionet e tjera që kishin për detyrë njohjen e studimin e gjendjes dhe për të zhvilluar propagandë në drejtim të Kosovës, për ato probleme themelore, lidhur me detyrat funksionale të sektorit pa i dubluar dhe zëvendësuar institucionet përkatëse në kryerjen e detyrave që kanë;

f) sektori për njohjen e gjendjes në Kosovë do të shfrytëzonte shtypin e botimet e nevojshme, informacionet që do të vinin nga përfaqësitë e jashtme shqiptare, të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të gjitha burimet e tjera të mundshme<sup>33</sup>.

Në përshtatje me veçoritë e detyrës funksionale dhe normat në fuqi, sektori mbante këto dokumente dhe evidenca: skedat për të dhënat që dilnin; indeksin e rregullt për gjendjen dhe veprimtarinë e organizatave patriotike e revolucionare, dokumentet dhe literaturën e domosdoshme që bënte fjalë për çështjen e shqiptarëve nën Jugosllavi; informacionet, raportet, studimet, që bënte sektori për udhëheqjen e partisë etj.<sup>34</sup>

5. Radio-Televizioni Shqiptar u angazhua të programonte, të blinte, të krijonte emisione të posaçme në radio e televizion për shqiptarët e Kosovës. Programi RTSH-së i paraqitej për miratim KQ të PPSH-së.

6. Universiteti i Tiranës çdo vit duhej të programonte botime, leksione etj., për shqiptarët e Kosovës.

7. Të njëjtën detyrë duhet ta bënte edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

8. Ndërmarrjet e tregtisë së jashtme krahas tregtisë kishin edhe detyra të posaçme për takime e shkëmbime me shqiptarët në Kosovë<sup>35</sup>.

Duke folur për periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1966, Enver Hoxha thoshte se “pas çlirimit dhe ‘vetëvendosjes’ titistët vendosën administratën e tyre në Kosovë, krijuan aparatet shtypëse,

<sup>30</sup> AQSH, 10/AP, viti 1966, dosja 171.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> Po aty.

<sup>35</sup> Arkivi Qendror i Shqipërisë, 10/AP, viti 1966. Dokumentacioni për veprimtarinë nga pikat 5, 6, 7 dhe 8 ruhet në Arkivin Qendror të Shqipërisë.

përgatitën kuadrat e tyre, organizuan partinë, propagandën dhe filluan kërdrinë që dihet nën maskën e shovinizmit barbar.<sup>36</sup>

Ndërkaq, duke e vlerësuar mënyrën e rezistencës e të luftës për t'i shpëtuar shfarosjes, Enver Hoxha shkruan se “populli shqiptar i Kosovës është mbrojtur formalisht, politikisht ose hapur nga shteti shqiptar.”<sup>37</sup> Mbështetja shihej në dy drejtime: “drejtimi i parë ishte lufta heroike që i bënte titistëve, kurse drejtimi i dytë ishte mbështetja e hapur e guximshme, duke mbrojtur shqiptarët e Kosovës.”<sup>38</sup>

Enver Hoxha e kishte idenë se duke e demaskuar politikën e regjimit jugosllav, duke e zbehur imazhin e Jugosllavisë, do të arrinte të pengonte ndërmarrjen e veprimeve të shtetit jugosllav kundër shqiptarëve dhe në disa raste e shtyn shtetin jugosllav të jetë më i kujdesshëm për veprimet që donte t'i merrte ndaj Kosovës. Mirëpo, ai zgjidhjen e çështjen së shqiptarëve nën Jugosllavi e shihte nga një prizëm tjetër dhe nga forma të tjera të veprimit, të cilat lëvizja ilegale politike në Kosovë nuk mund t'i pranonte tërësisht në këtë kohë dhe në këto rrethana si platformë të veten të veprimit.

Kështu, duke analizuar luftën e shqiptarëve të Kosovës Enver Hoxha shprehte edhe disa nga mangësi të saj, si: “1. Lufta e shqiptarëve të Kosovës për të drejtat demokratike nuk ishte e organizuar, 2. Nuk është e udhëhequr, 3. Është e çoroditur politikisht dhe organizativisht, 4. Ajo ndjek me shumë pak ndjeshmëri tiparet e vjetra të paraluftës, duke dalë me parulla “Luftë për t'u bashkuar me Shqipërinë”, 5. U lejua emigrimi në masë i shqiptarëve në Turqi dhe nuk organizoi punën që asnjë shqiptarë të mos lëviz nga trualli i të parëve, 6. U lejua shitja serbëve të tokës së shqiptarëve, 7. Nuk u luftua sa duhet dhe si duhet për të fituar nga koniunktura që titizmi ishte i detyruar të bëjë në hapjen e shkollave shqipe, 8. Lufta zhvillohej në grupe sekrete që s'kanë asnjë sekret për udhëheqës, 9. Lufta nuk ka marrë parasysh sa duhet luftën e popujve të tjerë të Jugosllavisë, 10. Mungon një udhëheqja marksiste leniniste që të çajë dallgët dhe të shfrytëzojë situatat dhe koniunktura”<sup>39</sup>.

Enver Hoxha, në këtë periudhë mendonte se “çështja e Kosovës nuk është e lehtë dhe as nuk mund të zgjidhet aq shpejt sa mendojnë disa njerëz kosovarë me vullnet të mirë,”<sup>40</sup> ndërsa sa i përket realizimit të qëllimeve për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, ai thotë se “ajo nuk mund të përcaktohet sepse nuk varet nga dëshirat”<sup>41</sup>. Lufta për çlirim e Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi, sipas platformës politike të udhëheqjes së Shqipërisë shikohej brenda hapësirës së shtetit jugosllav, sepse politika e udhëheqjes së Shqipërisë nuk ishte e gatshme të pranojë që lufta e Kosovës të shpërthejë kufijtë e Jugosllavisë.

Enver Hoxha shkruante se “populli i Kosovës duhet ta kuptojë se në këto koniunktura asnjëherë Shqipëria nuk mund ta atakojë as ta sulmojë Jugosllavinë. RPSH-ja s'mund të jetë kurrë agresor. Në qoftë se Jugosllavia atakon Shqipërinë ai është problem tjetër, Shqipëria do të mbrohet, do të luftojë dhe do të fitojë dhe problemi i Kosovës vihet krejt ndryshe.”<sup>42</sup>

Për çështjen se a duhet të ketë luftë të armatosur, Enver Hoxha shprehet kundër, duke e denoncuar si një gabim fatal. “Një gjë e tillë s'mund të ketë sukses pa pritur shumë kohë më parë. Mbase nuk mjafton as guximi as trimëria individuale. Revolucioni është nga çështjet më serioze, prandaj duhet përgatitur.”<sup>43</sup>

Udhëheqja shqiptare vazhdon të shikonte luftën e Kosovës të lidhur ngushtë me luftën e popujve të Jugosllavisë dhe në “vëllazërim” me ta, sepse lufta e izoluar e Shqipërisë me Jugosllavinë, sipas tyre do të ishte vetëvrasje<sup>44</sup>. Sipas udhëheqjes shqiptare duhet përgatitur edhe përfitimin nga situatat e krijuara. Në radhë të parë duhet forcuar pozitat në vend për të drejtat demokratike<sup>45</sup>. Enver Hoxha mendonte se “udhëheqja shqiptare në Kosovë ishte e shitur tek titizmi, prandaj ata janë shqiptarë shovinistë plus revizionistë, atyre nuk duhet t'u kihet besim, por t'u gjendeshin pikat më të dobëta që të lëkunden”<sup>46</sup>

Ishte tepër iluzore, që në këtë kohë, të mendohej se shqiptarët së bashku me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe me mbështetjen e tyre do ta zgjidhnin çështjen e Kosovës, duke e ditur se në këtë kohë federata jugosllave dhe republikat e saja kishin arritur të tejkalonin kontradiktat mes tyre dhe se Titoja kishte shtrirë influencën e tij në të gjitha strukturat e shtetit jugosllav dhe prestigji i tij në bllokun perëndimor ishte i lartë.

<sup>36</sup> AQSH, 10/AP, viti 1966, dosja nr. 185, 12.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> Po aty, 13-15.

<sup>40</sup> Po aty, 16.

<sup>41</sup> Po aty, 16.

<sup>42</sup> Po aty, 16.

<sup>43</sup> Po aty, 16.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> Po aty, 19.

Në aspektin propagandues Shqipëria asnjëherë nuk e ndali veprimtarinë e saj rreth kritikës drejtuar regjimit dhe udhëheqjes jugosllave. Në disa raste nga dokumentet shohim se Enver Hoxha dërgonte kritika të ashpra edhe në drejtim të udhëheqjes kosovare dhe pastaj kërkonte informacione kthyes mbi efektet e asaj kritike në raport me udhëheqjen kosovare. Ai dëshironte të kuptonte afërsinë e kësaj udhëheqjeje me udhëheqjen e nivelit federativ<sup>47</sup>. Enver Hoxha në luftën ideologjike kundër Jugosllavisë përdorte edhe elementin e varfërisë dhe politikat diskriminuese që zbatonte federata jugosllave ndaj zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Më 16 nëntor 1967, Enver Hoxha shkruan një artikull me titull “Demagogjia titiste nuk mund të mbulojë plagët e hapura të Kosovës”. Synimet ishin demaskimi i demagogjisë titiste mbi gjendjen ekonomike politike dhe kulturore, duke bërë krahasime me gjendjen në republikat e tjera të Jugosllavisë. Në vitin 1967 ishin thelluar edhe më shumë diferencat midis Kosovë dhe viseve të tjera të zhvilluara të

Jugosllavisë. të ardhurat kombëtare për Slloveninë ishin 7588 dinarë të rinj, ndërsa në Kosovë ishin 730 dinarë aq sa mesatarja jugosllave e vitit<sup>48</sup>. Këtë disproporcion Enver Hoxha e lidhte me vijën diskriminuese të politikës titiste dhe politikë shoviniste dhe të trajtimit të Kosovës vetëm si burim lëndësh të para si një zonë e shtypjes koloniale për forcat e tepërta e të pakualifikuara të Serbisë dhe të Malit të Zi<sup>49</sup>.

Enver Hoxha periudhën e asaj kohe e quan “qetësi relative e imponuar nga krizat dhe koniunktura e brendshme që bënte regjimi titist, ndërsa “liberalizmin kulturor” në Kosovë, si manovra mashtruese të rrezikshme që paralajmëronin se titistët po kurdinshin ndonjë tragjedi të re për shfarosjen e kombësisë shqiptare”<sup>50</sup>.

Udhëheqja partiake dhe shkencore shqiptare mori nën mbrojtje luftën e shqiptarëve të Kosovës, të Malit të Zi e të Maqedonisë, të cilët “kanë të drejtë plotësisht të luftojnë me këmbëngulje e vendosmëri që të kthehen në vendin e vet të gjithë emigrantët brenda e jashtë Jugosllavisë. Ata kanë të drejtë juridike, morale e historike të kërkojnë të prapësin nga vatrën e tyre koloniale serbe e malazeze. Ata kanë të drejtë të flasin e të shkruajnë lirshëm gjuhën amtare, të kenë sistemin shkollor shtypin e literaturën në gjuhën shqipe, bibliotekat teatrot, institutet e studimeve dhe të përhapjes së kulturës së tyre kombëtare, të kenë administratën e përbërë nga shqiptarët, njerëz të zgjedhur nga populli dhe jo të imponuar nga titistët. Kanë të drejtë të luftojnë kundër grabitjes dhe shfrytëzimit dhe t’i shfrytëzojnë për interesat e tyre.”<sup>51</sup>

Gjatë kësaj periudhe qëndrimi zyrtar politik i Enver Hoxhës dallohej shumë nga qëndrimi dhe platforma politike e lëvizjes ilegale në Kosovë. Derisa kjo e fundit me këmbëngulje kërkonte modalitete shumë të avancuara për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve nën Jugosllavi dhe përmes formave të ndryshme, Shqipëria ishte shumë më e kujdesshme dhe kërkonte që në këtë kohë çështja të zgjidhej përmes një autonomie të zgjeruar politike. Pra, sipas Enver Hoxhës detyrat kufizoheshin brenda kuadrin të zgjerimit të të drejtave demokratike të një autonomie të zgjeruar<sup>52</sup>.

### *Kërkesa për Republikën e Kosovës dhe qëndrimi i Shqipërisë*

Më 27 nëntor 1968, në Prishtinë e në disa qytete të Kosovës, si dhe në disa qytete të Maqedonisë, për herë të parë u kërkua publikisht, nëpërmjet demonstratave të organizuara nga lëvizja kombëtare e kohës, që Kosova të bëhej republikë. Pos kërkesës kryesore për Republikën e Kosovës, në ato demonstrata ishin shtruar edhe kërkesa të tjera, si: “Duam vetëvendosje deri në shkëputje”, “Duam bashkimin e viseve të banuara me shqiptarë me Kosovën”, “Duam Kushtetutë”, “Duam Universitet” etj.<sup>53</sup>

Demonstratat e vitit 1968 reflektuan ndikimin e tyre në disa drejtime<sup>54</sup>. Në raport me federatën jugosllave ato sikur përshpejtuan procesin për ndryshime kushtetuese, që në njëfarë forme erdhën në kohën e konfliktit të madh ndërmjet vijës politike të Titos dhe asaj të Rankoviçit, në të cilën Tito arriti t’i shfrytëzojë këto ngjarje në favorin e luftës kundër vijës politike proetatiste të Rankoviçit.

Po ashtu këto ngjarje edhe njëherë treguan se çështja e shqiptarëve nën Jugosllavi nuk kishte rezultuar m ndonjë zgjidhje të pranueshme, prandaj u shtrua nevoja për ndryshime kushtetuese.

<sup>47</sup> AQSH, 10/ Ap, viti 1970-1971, dosja nr.387/1, 1.

<sup>48</sup> AQSH, 10/ Ap, viti 1967, dosja nr. 19, 15.

<sup>49</sup> Po aty.

<sup>50</sup> Po aty, 17.

<sup>51</sup> Po aty.

<sup>52</sup> Po aty, 19-20.

<sup>53</sup> Arkivi i Kosovës, Gjykata e Qarkut Prishtinë, Aktgjykimi kundër Osman Dumoshit dhe anëtarëve të tjerë të Grupit të të rinjve të LRBSH-së, 7 prill 1969.

<sup>54</sup> Arkivi i Kosovës, Mbledhja e Tretë e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës e Metohisë, Prishtinë, 9. 12. 1968.



Demonstratat e vitit 1968 reflektuan edhe në pozitën e shqiptarëve në Maqedoni. Në një dokument të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, duke folur për këtë ndikim thuhej: “Duhet thënë se ngjarjet e nëntorit dhe dhjetorit të vitit 1968, shkaktuan njëfarë tronditje në udhëheqjen e Maqedonisë dhe nga frika e pasojave të mëtejshme u detyruan të bëjnë ndonjë lëshim. Për këtë Krste Crvenkovski (ish-kryetar i Lidhjes Komuniste të Maqedonisë – nën. E.Ç.) dhe kryetari i tanishëm i Lidhjes Komuniste të Maqedonisë, Angel Çemerski, kanë vajtur herë pas here në aktivin politik të qytetit të Dibrës, Tetovës dhe Gostivarit, ku janë detyruar të flasin edhe për të drejtat e shqiptarëve të Maqedonisë, si për gjuhën, flamurin dhe kulturën e tyre. Në aktivin politik të Dibrës, më 5 tetor 1970 Angel Çemerski, duke folur për barazinë midis kombeve dhe kombësive, u mburr duke thënë se po u japim të drejta të gjera shqiptarëve.”<sup>55</sup> Ndërsa te shqiptarët në Maqedoni ndihej një lëvizje e madhe patriotike dhe punohej vazhdimisht në drejtim të bashkimit të komunave shqiptare me Kosovën, ose të paktën që Kosova të njihej si qendër politike, ekonomike, arsimore e kulturore e shqiptarëve nën Jugosllavi<sup>56</sup>. Prandaj, demonstratat e vitit 1968 e shtynë politikën e Maqedonisë, Malit të Zi, të Serbisë, por dhe të federatës jugosllave që t’i rishqyrtojnë politikatat e tyre në raport me shqiptarët.

Politika jugosllave ishte zënë ngushtë me këto ngjarje, saqë edhe vetë kreu i federatës jugosllave, Tito, u mundua, në një konferencë me gazetarë të huaj, t’i paraqes këto ngjarje si një lëvizje thjesht studentore, sikurse që kishte ndodhur në disa vende të Evropës<sup>57</sup>.

Edhe pse shtypi jugosllav dhe politika jugosllave tentuan të mbyllin reflektimin e ngjarjeve që ndodhën, duke tentuar t’i nxjerrë ato si reagime të pakënaqësisë sociale, si revoltë studentore, apo si rrjedhojë e liberalizimit të jetës politike në Jugosllavi, demonstratat e ndodhura pala jugosllave nuk mundi t’i fshihte dhe nga dokumentacioni amerikan që i kemi në dispozicion, duke folur për situatën politike në Evropën Lindore, posaçërisht pas daljes së Shqipërisë nga Pakti i Varshavës, acarimi i raporteve BRSS-Shqipëri, duke folur për raportet Shqipëri-Jugosllavi, për ngjarjet e vitit 1968 në Kosovë, në dokument thuhet: “Shqipëria bëri pak për largimin e elementeve të kahershme irrituese në marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë. Rifillimi i sulmeve të propagandës shqiptare në tetor dhe trazirat e fundit të nëntorit në mesin e mbi 1 milion shqiptarëve në provincën autonome jugosllave të Kosovë e Metohisë, edhe njëherë i acaruan marrëdhëniet e Tiranës me Beogradin.”<sup>58</sup> Prandaj, nga ky dokument shihet se politika e SHBA-ve i kishte përcjellë me kujdes demonstratat që ndodhën në Kosovë dhe reflektimet e saj në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe në gjithë kampin socialist.

Në vazhdim të informacionit rreth këtyre ngjarjeve thuhet: “Fakti se trazirat e Kosovës ndodhën në të njëjtën kohë me festimin e ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, shkaktuan spekulime se mos shqiptarët mund të ketë ndihmuar në nxitjen e trazirave.”<sup>59</sup>

Pas demonstratave të vitit 1968, pala jugosllave ngriti në mënyrë indirekte akuza në raport me Shqipërinë se në këto ngjarje kishte gisht edhe faktori i jashtëm. Edhe në qarqet ndërkombëtare Shqipëria është parë si një vend i cili mund t’i ketë nxitur demonstratat e vitit 1968, për shkak të qëndrimit të saj antijugosllav dhe të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve nën Jugosllavi. Më tutje në këtë dokument rreth mënyrës së ndikimit të Shqipërisë thuhet: “Ndoshta përmes hapave të tillë si editoriali i “Zërit të Popullit”, më 24 nëntor, ku dënohej ashpër “shtypja e dhunshme”, “shfrytëzimi i pashembullt ekonomik” dhe “deportimet dhe gjenocidi kundër pakicës shqiptare. Këto zhvillime e bënë të ardhmen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave krejtësisht të paparashikueshme.”<sup>60</sup>

Demonstratat e vitit 1968, edhe në raport me politikën amerikane, kishin zgjuar kureshtjen, për reflektimet e tyre shumëdimensionale. Sa i përket politikës së Shqipërisë rreth demonstratave të vitit 1968 dhe kërkesave të shtruara në ato demonstrata, ajo nuk kishte arritur të krijonte dhe të shprehte ndonjë qëndrim konsekuent. Ajo, në realitet, bënte propagandë të madhe në mbështetje të të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, në kuadër të të drejtave për gjuhë, për kulturë, për arsim, si të drejta njerëzore, kurse sa i përket çështjes që kishte të bënte me statusin e Kosovës, dukej paksa më e rezervuar, madje në disa raste me qëndrimet e saj shprehte një paqartësi, duke rënë edhe në pozita kundërshtuese.

Politika e shtetit shqiptar llogariste se ngjarjet e ndodhura në Kosovë, në këtë kohë do të përdroreshin për destabilizimin e plotë të paqes në Ballkan dhe ndërhyrjeve të mundshme të shteteve “imperialiste” dhe

<sup>55</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, viti 1971, dosja nr. 643, 14.

<sup>56</sup> PO aty.

<sup>57</sup> Enver Hoxha, Ditari politik për çështje ndërkombëtare 1968-1969 (për përdorim të brendshëm), Tiranë, 327.

<sup>58</sup> National Archives and Record Administration (NARA), Fondi i Departamentit të Shtetit, Memorandum i Thomas L. Hughes dërguar Departamentit të shtetit, sektorit të inteligjencës dhe kërkimit, 2 janar 1969.

<sup>59</sup> Po aty.

<sup>60</sup> Po aty.

“socialimperialiste” në Jugosllavi dhe se kjo ndërhyrje do të sillte edhe reflektimet e saj në çështjet e sigurisë dhe të sovranitetit të Shqipërisë.

Në shumë dokumente, të cilat pasqyrojnë qëndrimet politike të shtetit shqiptar, çështja kryesore ishte se çdo të bëhet me shtetin jugosllav, do të pushtohet nga rusët apo nga amerikanët dhe në rrethana të tilla çka do të bëhet me Shqipërinë, a do të rrezikohet integriteti i saj shtetëror. Prandaj, ajo edhe në zhvillimet e rëndësishme që në njëfarë forme shkonin në favorin e zgjidhjes së çështjes nacionale, dukej e tërhequr dhe pozicionuar në ruajtjen e status quos.

Më 5 dhjetor 1968 Enver Hoxha në disa shënime dëshmon qëndrimin e shtetit shqiptar. Ai fillimisht thotë se “më 27 nëntor në Prishtinë dhe në shumë qytete të Kosovës u zhvilluan demonstratat e rinisë studentore”<sup>61</sup> për të vazhduar më tutje “Sipas njoftimeve zyrtare pati një të vrarë<sup>62</sup> dhe shumë të plagosur nga njerëzit e UDB-së, që sulmuan demonstruesit dhe nga demonstruesit që u mbrojtën.”<sup>63</sup> Shteti jugosllav i vlerësoi demonstratat e organizuara nga të rinjtë shqiptarë të cilësuar si armiq dhe të frymëzuar nga jashtë<sup>64</sup>. Enver Hoxha në përgjigjet e kësaj akuze të tërthortë vazhdoi të mbajë vijën e mosndërhyrjes në punët e brendshme të Jugosllavisë. Ai shkruante se “natyrisht ne nuk kemi as gishtin më të vogël në këto demonstrata, ne nuk zhvilluam asnjë punë agjente dhe subversive as në Jugosllavi, as në Kosovë. Titistët e dinë këtë, por ia donë puna të shpifin.”<sup>65</sup> Hedhjen e parullave proshqiptare Enver Hoxha ia atribuoi “provokuesve të futur në radhët e demonstruesve që duan t’i japin ngjyrë tjetër demonstratave.”<sup>66</sup> Enver Hoxha shfaq hapur mendimin për çështjen e Kosovës si një çështje e të drejtave nacionale<sup>67</sup>.

Këtë qëndrim ai e argumentoi në qëndrimin e Beogradit ndaj maqedonasve grekë, ku “Titoja deklaroi se është një e drejtë e tyre të mbrojnë maqedonasit e Greqisë, kurse Tirana s’paska të drejtë t’i mbrojë demonstruesit shqiptar dhe mbrojtjen e quan një krim.”<sup>68</sup>

Sipas udhëheqjes shqiptare këto demonstrata dëshmuuan se “regjimi Tito-Rankoviç nuk ia doli me terror dhe shtypje të shuajë lëvizjen patriotike kombëtare të shqiptarëve nën Jugosllavi. Pas rënies së Rankoviçit, Titoja bëri disa lëshime nga halli, shqiptarët fituan diçka por përsëri janë të shtypur.”<sup>69</sup>

### *Hezitimi i Shqipërisë ndaj veprimtarisë së Lëvizjes nacionale në Kosovë*

Lëvizjet politike që zhvilloheshin në periudhë të organizuara nga forcat patriotike, me kërkesa të sublimuara, i kërkesa për Republikën e Kosovës; për bashkimin e trojeve të pushtuara shqiptare nën Jugosllavi në një republikë dhe për bashkimin e trojeve të pushtuara shqiptare me Shqipërinë<sup>70</sup>. Nga qarqet politike në Shqipëri, këto lëvizje ishin pritur me dilema të madhe, se çka do të mund të ndodhte më tutje dhe në mënyrë konstante shprehej frika dhe dyshimi se mos këto lëvizje ishin konspiracion i shërbimeve të fshehta jugosllave apo i forcave reaksionare borgjeze.

Kjo logjikë e frikës kishte bazën e saj, sepse Beogradi kishte ndërtuar struktura brenda Kosovës përmes kundërshtarëve politikë të regjimit të Shqipërisë<sup>71</sup>. Ky fakt bazohet edhe në një dokument të legatës shqiptare në Beograd, të drejtuar institucioneve politike të shtetit shqiptar. Legata shqiptare në Beograd kishte marrë një kërkesë nga grupi patriotik i Kosovës, për mbështetje nga shteti shqiptar, për vazhdimin e luftës për çlirimin e Kosovës, i cili kërkonte edhe më tutje udhëzime se si të vazhdojë punën dhe si të ecnin me kohën.

Në përgjigjen që ia ktheu drejtorja e posaçme e Ministrisë së Punëve të Jashtme e Shqipërisë, legatës shqiptare në Beograd thuhej: “Legata jonë në Beograd na njofton më 19. 9. 1968 se paraqiten shpesh kosovarë, të cilët kërkojnë, që “duke përfutur nga situata aktuale në Republikën Popullore të Shqipërisë, t’u japë kosovarëve ndihmë të gjithëmbarshme për të realizuar aspiratat për shkëputje nga Jugosllavia e bashkimin me Shqipërinë”<sup>72</sup>. Në dokument thuhet edhe “Legata, shprehet se nuk dyshon te këta njerëz, por kërkon që Ministria ta udhëzojë përfaqësinë mbi qëndrimin që duhet t’u japë kosovarëve, sepse nuk ka

<sup>61</sup> AQSH, 10/ Ap, viti 1968, dosja nr. 238, 1.

<sup>62</sup> Në demonstratat e 27 nëntorit të vitit 1968 në Prishtinë, është vrarë nxënësi 17-vjeçar Murat Mehmeti, nga Prishtina.

<sup>63</sup> AQSH, 10/ Ap, viti 1968, dosja nr. 238, 1.

<sup>64</sup> Po aty, 1-2.

<sup>65</sup> Po aty, 2-3.

<sup>66</sup> Po aty, 4.

<sup>67</sup> Po aty, 4-5.

<sup>68</sup> Po aty, 5-6.

<sup>69</sup> AQSH, 10/ Ap, viti 1968, dosja nr. 238, 8.

<sup>70</sup> Mr. Ethem Çeku, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981; Ethem Çeku, Shekulli i ilegales, Prishtin[, 2004.

<sup>71</sup> National Archives and Record Administration (NARA), Dokument i Departamentit të Shtetit, 6 korrik 1953.

<sup>72</sup> AQSH, MPJ, Viti 1968, Dosja b/7-2/b, nr. 360, 1-2.

udhëzime precise<sup>73</sup>. “Ne mendojmë, theksohej në përgjigjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë se, shokët e përfaqësuesit nuk kanë të drejtë që t’u besojnë apriori kosovarëve, që u paraqiten me kërkesat e kësaj natyre, prandaj mendojmë t’u japim këto porosi: të jeni vigjilentë ndaj atyre që ngrenë të tilla kërkesa, të mbani parasysh se neve nuk ngremë pretendime territoriale zyrtare ndaj Jugosllavisë, sepse zgjidhjen e problemit të Kosovës nuk e ndajmë nga zgjidhja e problemit të përgjithshëm të Jugosllavisë, domethënë nga rrëzimi i klikës titiste dhe ardhja në fuqi e një udhëheqje marksiste-leniniste, në vend të saj, e cila në kuadrin e zgjidhjes së çështjes nacionale në Jugosllavi, do të jepte popullsisë shqiptare të drejtën për vetëvendosje me plebishit. Në këtë kuptim popullsia shqiptare duhet të mbështes forcat eventuale marksisteleniniste jugosllave për realizimin e synimeve të tyre.”<sup>74</sup> Në atë dokument thuhej qartazi gjithashtu: “Qëndrimi ynë ndaj Jugosllavisë dhe çështjes së Kosovës, në këtë situatë, nuk ka ndryshuar. Ne këshillojmë kosovarët që të luftojnë si edhe deri tani për të fituar sa më shumë të drejta në të gjitha drejtimet, duke synuar që të arrijnë të gëzojnë po ato të drejta që i gëzojnë edhe kombësitë e tjera në Jugosllavi.”<sup>75</sup>

Po ashtu, në dokumentin e lartpërmendur thuhet: “Për sa i përket çështjes se ne jemi për republikë apo krahinë autonome, juve i keni udhëzimet. Përsëris, se ne nuk jemi për krijimin e republikës, sepse kjo nuk do të zgjidhte problemin. Ai do të zgjidhet vetëm ashtu sikurse thuhej më lart.”<sup>76</sup>

Në vitin 1968 Shqipëria me qëndrimet e saj shprehte hapur mosgatishmërinë e saj për të hyrë në zhvillime më dinamike rreth statusit politik të Kosovës. “Kur vizitorët, cilët do qofshin ata, kërkojnë mendimin tonë për çështjen e krijimit ose jo të republikës së Kosovës, nga ana e juaj të mos u jepet të kuptojnë qëndrimet tona, por t’u thuhet se kjo çështje ju takon juve vetë të vendosni.”<sup>77</sup> Në vazhdim të kësaj t’u thuhet: “E rëndësishme për mendimin tonë është që ju të fitoni sa më shumë të drejta dhe të luftoni që t’i gëzoni po ato të drejta që gëzojnë edhe kombësitë e tjera në Jugosllavi. Për këtë ju keni pasur dhe do të keni përkrahjen e Republikës Popullore të Shqipërisë.”<sup>78</sup>

Politika zyrtare e udhëheqjes shqiptare e asaj kohe, në raport me lëvizjen patriotike kombëtare nuk ishte gjithmonë konsekuente dhe parimore, në disa raste ishte thellësisht e ideologjizuar, në momente të caktuara edhe kundërtënëse, madje edhe mohuese. Në raste të ndryshme duket se atë e preokuponin më shumë pasojat që do të sillte statusi i ri politik e juridik i Kosovës, përkatësisht refleksionet e tij në raport me federatën jugosllave, me republikat e tjera dhe nga do të shkonte Jugosllavia pas këtyre zhvillimeve mjaft dramatike në këtë pjesë të Evropës.

Duke iu referuar një dokumenti të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, të asaj kohe, po citojmë: “Kërkesa për një republikë autonome të Kosovës filloi të gjej vend edhe në shtypin e krahinës, ku argumentohej plotësisht kjo kërkesë. Në shumë shkrime që botohen për këtë qëllim, jepen të dhëna e shifra të popullsisë së republikave të Jugosllavisë, të përbërjes nacionale të tyre etj. dhe indirekt del pyetja pse p.sh. Mali i Zi, pse Maqedonia që kanë respektivisht 2,8 % dhe 6,6 % të popullsisë së Jugosllavisë dhe përbërja e popullsisë së tyre kombëtare është 72 % dhe 71 % janë republika, kurse Kosova që ka 5,2 % të popullsisë së përgjithshme të Jugosllavisë dhe 74 % të popullatës së saj janë shqiptarë nuk është republikë, por krahinë autonome.”<sup>79</sup> Në atë dokument më tej thuhet: “Këto kërkesa të popullit shqiptar të Kosovës prekën jo vetëm interesat e tri republikave të Jugosllavisë me të cilat kufizohet krahina Kosovës, të cilat kanë brenda kufijve të tyre territore të gjera me popullsi shqiptare, por ato përbëjnë edhe një rrezik për të gjithë sistemin federativ jugosllav. Prandaj Titoja me gjithë premtimet e mëdha që kishte dhënë për Kosovën, mori masa për t’u prerë hovin këtyre kërkesave, sepse realizimi i tyre rrezikonte edhe pozitën e vetë Titos”<sup>80</sup>. Nga ky dokument duket se, qeverinë shqiptare e shqetësonin edhe implikimet që mund të shkaktonin kërkesat e shqiptarëve nën Jugosllavi, në lidhje me fatin e udhëheqjes jugosllave dhe raportet e brishta ndërmjet republikave jugosllave.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të dokumenteve të kohës, arrihet në përfundimin se sipas politikës zyrtare shqiptare, në Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqiptare nën Jugosllavi, ishin shquar tri vija politike: E para, forcat e shëndosha patriotike të shqiptarëve të Kosovës, duke e parë se në kushtet konkrete të gjendjes në Jugosllavi, kërkesat e tyre për krijimin e republike të veçantë dhe bashkimin brenda saj të gjitha tokave shqiptare nuk mund të realizohej, u munduan dhe bënë të gjitha përpjekjet nëpërmjet kushtetutës së re të fitonin sa më shumë të drejta për barazi kombëtare dhe t’i largoheshin sa më shumë vartësisë serbe.<sup>81</sup> Me

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Po aty.

<sup>75</sup> Po aty.

<sup>76</sup> Po aty.

<sup>77</sup> Po aty, 1-2.

<sup>78</sup> Po aty, 1-2.

<sup>79</sup> AMPJ, viti 1969, Dosja b/7-2/b, nr. 461, 2.

<sup>80</sup> Po aty.

<sup>81</sup> Po aty. 3.

këto forca u bashkua edhe udhëheqja e Kosovës që i shërbeu me besnikëri Titos. Forca e dytë, që luftoi që krahinës së Kosovës të mos i jepeshin më tepër të drejta sesa ajo kishte, ishin forcat shoviniste sero-malazeze në Kosovë<sup>82</sup>. Rryma e tretë përfaqësohej nga shqiptarë, të cilët duke u mos e vlerësuar drejtë situatën e brendshme të Jugosllavisë, u shfaqën hapur kundër platformës së Lidhjes Komuniste të Kosovës dhe i konsideruan si fare të pakta e të pamjaftueshme ato të drejta, që i jepte kushtetuta popullsisë shqiptare të Kosovës.<sup>83</sup> Pikëpamjet e këtij grupi u dënuan nga udhëheqësit e Kosovës, ndërsa kërkesat e tyre i quajtën joreale dhe të bëra me qëllime tendencioze.<sup>84</sup> Në realitet të dy konceptet politike për autonomi dhe ajo serbomalazeze, gjithnjë ishin minore. Koncepti i mëvetësisë së

Kosovës, i shoqëruar sipas rrethanave, me elemente të republikës, ishte në fakt koncepti zotërues dhe më i pëlqyer për shumicën e shqiptarëve të Kosovës. Nga kjo që u tha më lart rezultoi se politika e shtetit shqiptar në atë periudhë ishte tejmas e përqendruar brenda koniunkturave politike të rrethanave të krijuara.

Ndërmarrja e çfarëdo lloj hapi të mundshëm jashtë atyre koniunkturave gjykohej përmes optikës ideologjike. Enver Hoxha dhe disa struktura të shtetit shqiptar, posaçërisht njerëzit e shërbimit informativ, e mbivlerësonin luftën ideologjike, si mundësi dhe mjet me efikasitet të jashtëzakonshëm kundër Jugosllavisë së Titos. Fjalimet e Enver Hoxhës dhe qëndrimet e tij politike për ngjarjet e caktuara në disa raste kalonin përmasat e propagandës së brendshme politike.

Prandaj, nga dokumentet e trajtuara dhe ngjarjet ndërkombëtare që ndodhën në vitin 1968 dhe lëvizjet e mëdha politike në disa republika të Jugosllavisë bënë që Shqipëria të ishte shumë e frikësuar për sigurinë e vet.

### *Qëndrimi i Shqipërisë ndaj ngjarjeve në Jugosllavi në fillim të viteve '70*

Jugosllavia, në disa etapa pas Luftës së Dytë Botërore, kishte kaluar nëpër disa kriza serioze politike. Konflikti me Stalinin; Plenumi i Brionëve; ngjarjet në Kroaci, në Serbi e në Slloveni<sup>85</sup>; lufta kundër grupeve të armatosura kroate etj., bënë që federata jugosllave të merrte goditje serioze politike. Të gjitha këto ngjarje që ndodhën në Jugosllavi, blloqet politike-ushtarake kundërshtuese si Pakti i NATO-s dhe Traktati i Varshavës, i përcillnin me kujdes të madh, duke dërguar flotat e tyre në brigjet e Adriatikut<sup>86</sup>. Të dy superfuqitë kishin sferat e interesit të tyre politik në Jugosllavi, që nga Konferenca e Jaltës këto interesa kishin mbetur të pandryshuara.

Ndërkaq, qeveria shqiptare i vrojtonte me kujdes, deri në imtësi, proceset që ndodhnin në Jugosllavi, duke i komentuar ato kryesisht sipas parimeve ideologjike dhe duke i shikuar implikimet e këtyre ngjarjeve në raport me Shqipërinë dhe me Kosovën. Kështu ndodhi edhe me qëndrimin e saj ndaj ngjarjeve të vitit 1971 në Kroaci, atëherë kur ndodhi lëvizja masive kroate, e njohur si “maspok”,<sup>87</sup> e cila mori dimensione të mëdha për kohën, sepse ishte një lëvizje e organizuar kundër tendencave centraliste të federatës jugosllave. Kjo lëvizje mjaft e fuqishme e kroatëve në esencë, kishte për qëllim mëvetësinë e Kroacisë nga federata jugosllave<sup>88</sup>.

Shqiptarët në trojet e pushtuara në Jugosllavi e mbështetën këtë lëvizje politike. Duhet vënë në dukje sidomos pjesëmarrja masive e studentëve shqiptarë, që studionin në atë kohë në Universitetin e Zagrebit. Në të gjitha lëvizjet kundër federaliste, të cilat ndikonin në dobësimin apo në shkatërrimin e federatës jugosllave, shqiptarët nga të gjitha trojet e tyre të pushtuara gjendeshin në radhët e atyre që e luftonin shtetin jugosllav. Mirëpo, politika zyrtare shqiptare, kërkonte me çdo kusht përmes kanaleve të ndryshme që shqiptarët nga trojet e pushtuara t'u rrinin larg konflikteve të tilla dhe lavdëronin politikën kosovare të kohës dhe shtypin kosovar të asaj kohe, që nuk i mbështetnin dhe nuk u jepnin hapësirë ngjarjeve në Kroaci. Kështu, në një dokument të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë dukej qartë interesimi i madh i

<sup>82</sup> Po aty.

<sup>83</sup> Po aty.

<sup>84</sup> Po aty.

<sup>85</sup> Dušan Bilandžić, vep. e cit., Branko Petranović, Momcilo Zecević, vep. e cit.

<sup>86</sup> Enver Hoxha, Ditari politik për çështje ndërkombëtare 1970-1971 (për përdorim të brendshëm), Tiranë, 319-324.

<sup>87</sup> Maspok, shkurtesa nga fjalët kroate “masovni pokret”, që në shqip do të thotë lëvizje masive. Kjo lëvizje qendron e vet e kishte në shtëpinë botuese “Matica Hrvatska”, nga e cila organizoheshin tubime ku artikulohehin kërkesat politike dhe ekonomike të kroatëve. Nëpërmjet revistave dhe gazetave të saj “Matica Hrvatska” nxiste disponimin nacionalist, më pas filloi të formojë degë të veta nëpër fabrika, pasqyronte politikën e punësimit në baza nacionale; paraqiste politikën e Jugosllavisë si burg për Kroacinë; paraqiste politikën e shfrytëzimit ekonomik të Kroacisë nga federata jugosllave dhe kërkonte me ngulmë krijimin e shtetit të pavarur kroat.

<sup>88</sup> Zdravko Vuković, 587.

Shqipërisë për këto ngjarje<sup>89</sup>, të cilat mund të pasqyroheshin në raportet shtetërore shqiptaro-jugosllave, por edhe të mundësisë që ato mund të shfrytëzoheshin nga serbët për të goditur shqiptarët e Kosovës<sup>90</sup>.

Në Beograd menjëherë pas ndryshimeve kushtetuese, serbët filluan reagimet e mëdha, duke u munduar t'i shfrytëzonin ngjarjet në Kroaci për të thirrur mbledhjen e Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, ashtu siç ishte thirrur për Kroacinë, tani të thirret edhe për Kosovën<sup>91</sup>. Ngjarjet që ndodhën në Slloveni, në Kroaci dhe në Serbi dhe gjendja e nder në Ballkan, kishin shtyrë shtetin shqiptar të jetë tepër i kujdesshëm në këtë vorbull të madhe politike. Ajo kërkonte që ta mbajë larg lëvizjen politike të shqiptarëve nën Jugosllavi dhe jashtë këtyre zhvillimeve politike që ndodhnin në federatën jugosllave. Implikimet e mundshme të udhëheqjes zyrtare të Kosovës dhe të lëvizjes ilegale e rrisnin mundësinë e veprimit të forcave nacional-shoviniste në Serbi për ta goditur Kosovën.

### *Kosova në luftën ideologjike të Shqipërisë*

Sistemet politike dhe shtetet ndërrojnë politikat e tyre, kryesisht për shkak të ndryshimit të raporteve të forcave politike, ekonomike dhe ushtarake. Shqipëria kishte disenjuar në politikën e saj të jashtme luftën ideologjike kundër Jugosllavisë. Ajo tentonte dhe besonte që përmes kësaj lufte të arrinte të ndihmojë zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve nën Jugosllavi. Ajo e ruajti me fanatizëm vijën ideore të Informbyrosë kundër Jugosllavisë<sup>92</sup>. Shqipëria ishte e bindur se do të vinte deri te ndryshimi i konstelacionit të forcave në favorin e saj. Prandaj, ajo me këmbëngulësi mbante flamurin e vijës ideologjike si çelës dhe si filozofi për zgjidhjen e të gjitha problemeve me të cilat ballafaqohej kombi shqiptar<sup>93</sup>. Mbivlerësimi i faktorit ideologjik në përballjen me Jugosllavinë, nga ana e politikës zyrtare shqiptare, në realitet ishte shprehje e pamundësisë dhe e pafuqisë së shtetit shqiptar për të bërë më tepër për çështjen e Kosovës, në periudha në caktuara. Në anën tjetër duhet theksuar se Shqipëria, për shumë arsye dhe rrethana historike, në shumë segmente nuk ishte e barabartë e Jugosllavinë. Jugosllavia kishte dalë nga lufta me një epërsi të madhe në aspektin ushtarak, ekonomik, politik. Ajo kishte ndërtuar raporte ndërkombëtare më të avancuara dhe më të qëndrueshme sesa Shqipëria dhe faktori relevant ndërkombëtar në përgjithësi, kishte interesa më të mëdha në Jugosllavi sesa në Shqipëri.

Padyshim se loja e Jugosllavisë me “dy porta” në fillim të viteve 50 e bëri atë lojtar të vlerësuar e kërkuar nga faktori ndërkombëtar. Si rrjedhojë disavantazhi i Shqipërisë ndaj Jugosllavisë erdhi duke u thelluar. Jugosllavia e Titos fitoi vlera të tjera pozitive në sytë e botës sidomos me rolin e fituar në lëvizjen e të “paangazhuarve” dhe politikën e mospërfshirjes në dy blloqet më të mëdha të formatuara, gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Udhëheqësit shqiptarë u përpoqën të përmirësonin imazhin e vet duke përdorur në një masë të madhe luftën ideologjike kundër Jugosllavisë. Thirrjet e hapura për rrëzimin e regjimit të Titos dhe të Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë si një organizatë antimarksiste, ishin një mjet konstant në luftën politike kundër Jugosllavisë nga udhëheqja komuniste e Shqipërisë. Këto thirrje për rrëzimin e

Titos nga pushteti, tek fuqitë e mëdha të kohës nuk gjetën mbështetje politike dhe nuk u panë me sy pozitiv.

Edhe vetë Enver Hoxha, së paku në formën zyrtare, zgjidhjen e çështjes së Kosovës e shihte nën dritën e refleksioneve ideologjike, madje dhe pritjen e ndryshimeve që duhet të bëheshin në strukturat e larta politike

<sup>89</sup> AMPJ, Viti 1978, Dosja b7/2, nr. 1366, 2-3.

<sup>90</sup> Po aty.

<sup>91</sup> Po aty.

<sup>92</sup> AMPJ, viti 1949, dosja 164, b/8. Në mbledhjen e mbajtur në nëntor të vitit 1949, pas informacionit që e dha përfaqësuesi i Partisë Punëtore Rumune, Gjergj Dezh, rreth Partisë Komuniste të Jugosllavisë, u adaptua një rezolutë në të cilën thuhej: a) se “Qeveria e Jugosllavisë i ka tradhtuar haptas interesat kombëtare të Jugosllavisë dhe është kthyer në vegël të verbër të politikës agresive të imperialistëve...; b) se Qeveria e Jugosllavisë ka marrë pjesë haptas në bllokun imperialist, duke qëndruar në të njëjtin front me reaksionin amerikan në çështjet me rëndësi ndërkombëtare...; c) se në politikën e brendshme klika Tito – Ranković, ka arritur si rezultat likuidimin e sistemit demokratik popullor dhe vendosjen e një regjimi policor të tipit fashist...; d) se ka filluar persekutimet edhe sulmet terroriste kundër komunistëve të vërtetë, të cilët qëndrojnë besnikë ndaj parimeve marksiste-leniniste dhe internacionalizmit...; e) prandaj lufta kundër klikës Tito konsiderohej nga Informbyroja si detyrë ndërkombëtare e partive komuniste dhe e partive motra, të ilët duhet t'i japin ndihmën e tyre më të madhe klasës punëtore të Jugosllavisë dhe fshatarëve punonjës, të cilët në luftën tyre janë të detyruar të ecin në të njëjtën rrugë që ecin edhe komunistët e atyre vendeve, kur është mbyllur rruga për punë legale. Si detyrë tjetër me rëndësi e partive komuniste dhe punëtore shtrohet edhe çështja e shtimit të forcave revolucionare në radhët e tyre, çrrënjosja e elementeve nacionaliste...”

<sup>93</sup> Bisedë e autorit me Ramiz Alinë, zhvilluar në Tiranë, më 22 maj 2008.

të udhëheqjes së Jugosllavisë. Enver Hoxha më 1966, lidhur me këtë, pos të tjerash thoshte: “Pakicat kombëtare duhet të ndjekin rrugën e drejtë revolucionare, rrugën e luftës kundër klikës së Titos për çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Shqiptarët e Kosovës nuk duhet të gënjejnë dhe të braktisin këtë rrugë. Kjo është e vetmja rrugë e çlirimit të tyre dhe e vetëvendosjes.”<sup>94</sup> Enver Hoxha besonte në një koalicion të mundshëm të forcave politike antititiste në gjithë Jugosllavinë, por koha që ishte para Titos dhe federatës jugosllave nuk lejonte asnjë mundësi të krijimit të koalicioneve të tilla të popujve të federatës jugosllave për rrëzimin regjimit të Titos. Kjo vjen edhe si rrjedhojë e kontradiktave të këtyre popujve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kurse sa i përket çështjes së bashkimit kombëtar, si platformë politike e grupeve dhe e organizatave ilegale, e cila në këto vite kishte marrë dimensione të theksuara të mbështetjes në trojet shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia. Enver Hoxha, lidhur me këtë theksonte: “Të luftohet që tani “për m’u bashku me Shqipërinë” kjo nuk të nxjerrë në shteg... Bashkimi me Shqipërinë ka qenë dhe është ideali i jetës së tyre, por për këtë ka vetëm dy rrugë, rruga revolucionare dhe rruga reaksionare shoviniste. E para, është rruga e luftës tok me popujt e Jugosllavisë, nën udhëheqjen e një partie marksiste-leniniste të vërtetë kundër revizionizmit modern titist, çlirimin dhe për socializmin e vërtetë me Jugosllavinë. Kjo rrugë e çon popullin shqiptar të Kosovës, në të drejtën e vetëvendosjes dhe deri në bashkim me atdheun Shqipëri; rruga tjetër është aventurë, në këtë rrugë, qoftë edhe duk luftuar shqiptarët e Kosovës do të bëhen preja e reaksionit jugosllav.”<sup>95</sup> Këto pikëpamje të Enver Hoxhës të bazuara në filozofinë e politikës idealiste të marksizëm-leninizmit, ishin në njëfarë mënyre formë e përpjekjes për të gjetur alibi, sesa shprehje e ndonjë mundësie reale për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Pikëpamjet e tilla të udhëheqjes së lartë shtetërore dhe partiake të Shqipërisë politika Jugosllave i shfrytëzonte për ta hequr nga rendi i ditës çështjen e okupimit të tokave shqiptare dhe për ta marginalizuar atë, sepse duke u zhvendosur nga çështja e pazgjidhur e Kosovës, vëmendja do të përqendrohej në luftën ideologjike mes “revizionizmit jugosllav” dhe “marksizëm-leninizmit shqiptar”.

Duke i parë këto dallime të mëdha mes këtyre dy vendeve dhe duke e ditur se Shqipëria nuk kishte aleatë të fuqishëm, për ta shtruar dhe për ta ndihmuar zgjidhjen e çështjes nacionale të shqiptarëve të robëruar, Jugosllavia nuk hyri në konflikte ideologjike, por në shumicën e rasteve ajo nuk iu kundërpërgjigjej akuzave të politikës zyrtare që i bënte Tirana në adresë të Beogradit.

Diplomacia jugosllave me format e saja të veprimit bëri ç’ ishte e mundur që diplomacinë e shtetit shqiptar ta mbante të izoluar dhe pa aleatë. Mjafton të përmendet vetëm rasti i incidentit të kanalit të Korfuzit për të kuptuar se sa e angazhuar ishte politika jugosllave në prishjen e raporteve mes Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë<sup>96</sup>. Po kështu përmes këshillave të këqija që iu servuan udhëheqjes së re të Shqipërisë në vitin 1946 nga udhëheqja jugosllave u sabotua edhe rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-të. Po ashtu jugosllavët nuk lejuan që Shqipëria të mbante kontakte të drejtpërdrejta me BRSS-në deri në vitin 1948 dhe kërkonte që çdo lëvizje e saj të bëhej nëpërmjet Beogradit. Prandaj, Jugosllavia që nga mbarimi i luftës deri tek shpërbërja e saj, investoi vazhdimisht në shtimin e konflikteve të brendshme në politikën shqiptare, në prishjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me botën perëndimore dhe në mbajtjen e Shqipërisë të izoluar.

Për të ilustruar këtë do të potencojmë një fragment nga raportet shqiptaro-jugosllave. Në një takim të mbajtur me Adil Çarçanin, si zëvendëskryeministër i Shqipërisë, Ilija Vakiqit, një nga udhëheqësit e Kuvendit Krahinor të Kosovës dhe Jovan Peçinoviçit, ambasadori i Jugosllavisë në Tiranë, ky i fundit ka thënë: “Mendimi ynë është që Shqipëria të jetë e paangazhuar, ashtu sikundër është jashtë çdo traktati dhe e pavarur. Kjo është në interes, jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe të popullit jugosllav.”<sup>97</sup>

Prandaj, mospërfshirja reale e Shqipërisë në blloqet ushtarake të kohës, pas vitit 1961, ishte në fakt edhe një akt në favor të Jugosllavisë, sepse i garantonte asaj kufirin jugor nga ndonjë sulm eventual, por edhe mosangazhimi i Jugosllavisë ishte po ashtu pozitiv për shtetin shqiptar, në të njëjtin kuptim. Por në fakt Jugosllavia mbante lidhje të hapura politike, ekonomike e diplomatike me vendet e të dyja blloqeve politike e ushtarake. Ndërsa Shqipëria mbeti konsekuente në politikën e saj tradicionale për të mos vendosur kontakte të bashkëpunimit me vendet e blloqeve.

Politika sovjetike, megjithëse ishte e ndarë zyrtarisht me Shqipërinë që në vitin 1961, përmes mjeteve që zotëronte një shtet i madh si Bashkimi Sovjetik, u mundua që përmes presionit politik dhe ushtarak ta mbante politikën dhe ekonominë shqiptare në gjendje tensioni. Dhe, kështu problemi i Kosovës ngulfatej nga pamundësia e Shqipërisë që të gjendej në disa fronte. Krahas “kërbaçit” politika sovjetike përdori edhe “kulaçin”, duke lenë një derë të hapur për rikthimin e Shqipërisë në gjirin e vendeve komuniste, duke marrë mbi vete edhe ndonjë përgjegjësi të vogël për prishjen e raporteve me Shqipërinë. Në funksion të kësaj ideje

<sup>94</sup> Enver Hoxha, Ditari politik për çështje ndërkombëtare 1966-1967 (për përdorim të brendshëm), Tiranë, 146.

<sup>95</sup> Po aty, 147.

<sup>96</sup> Miscarriage of justice -The Corfu Channel case (Keqpërdorimi i drejtësisë, Rasti i Kanalit të Korfuzit) Published by The Albanian Society 26 Kambridge Road, Ilfor Essex.

<sup>97</sup> AMPJ, Viti 1973, 870, Dosja 230, 10.

Bashkimi Sovjetik herë pas herë i bënte thirrje Shqipërisë për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Nga dokumentacioni arkivor i kohës, i shqyrtuar, del se politika dhe diplomacia shqiptare e kishte të vështirë përballimin me sukses të lojërave politike të fuqive të mëdha<sup>98</sup>.

Në etapat e ndryshme, e sidomos pas Luftës së Dytë Botërore dhe posaçërisht gjatë periudhës së luftës së ftohtë shtetet e fuqishme zbatonin diplomaci të dyfishtë me vende më të vogla<sup>99</sup>.

Këto lojëra politike e diplomatike që bënin posaçërisht vendet të cilat ishin nën ombrellën e Paktit të Varshavës, e në disa raste edhe Greqia dhe Italia, shtetin shqiptar e vënin në pozita mjaft të vështira dhe tejet të palakmueshme, prandaj qëndrimet politike të Enver Hoxhës dhe të politikës zyrtare shqiptare, ndonjëherë duhet t'i shohim edhe nën reflektimet e këtyre situatave të krijuara, sidomos kur ishte në pyetje sovraniteti i vetë shtetit shqiptar, të cilit vazhdimisht i kanosej rreziku<sup>100</sup>.

Në rrethanat e ndërlikuara ndërkombëtare dhe me politikën e izolimit që ndiqte Shqipëria, aftësia e saj për të krijuar koalicionet e për ta përkrahur luftën e shqiptarëve nën Jugosllavi, në funksion të avancimit të statusit të tyre politik, vështirësohej gjithnjë e më shumë. Në këtë këndvështrim, Enver Hoxha, nuk kishte ndonjë qëndrim konstant, të fortë dhe veprues as ndaj kërkesës për Republikën e Kosovës. Ai ishte i mendimit se shqiptarët e Kosovës do të duhej ta përcillnin me kujdes luftën e brendshme mes republikave dhe dobësimin e pozitës së Serbisë, pas rënies së Rankoviçit dhe të shikonin si të përfitonin sa më shumë nga ky dobësim. Gjatë kësaj periudhe politika e tij asnjëherë nuk u shpreh për mbështetjen e luftës së armatosur, si metodë e mundshme për çlirimin e tokave shqiptare. Ai nuk e mbështeti asnjë formë të lëvizjes ilegale politike në Kosovë për të kaluar nga pozita e luftës paqësore në një luftë armatosur. Ai, në këtë mënyrë mbështeste më shumë zgjidhjen e problemit brenda strukturave të federatës jugosllave (deri në vitin 1981), që më shumë dukej se ishte pasojë e rrethanave, sesa ndonjë përcaktim real dhe konsekuent për ose kundër çfarëdo zgjidhjeje.

Prandaj, në këtë kohë, duke zhvilluar dhe zbatuar aso politikash dhe qëndrimesh, Shqipërinë dhe udhëheqjen e saj politike nuk i gjejmë të përgatitur për t'u vënë hapur në mbrojtje të kërkesës për Republikën e Kosovës.

Duke u ndalur te viti 1966, në ditarin e tij politik, Enver Hoxha, thekson: “Dëgjojmë të flitet për një republikë të Kosovës. Kosovarët patriotë e revolucionarë, në këto momente duhet të tregohen shumë të kujdesshëm ndaj revizionistëve titistë, të cilët mund të luajnë edhe kartën e krijimit gjoja të një “republike shqiptare-kosovare” në vend të krahinës autonome, për të gënjyer shovinizmin kosovar, për të shtypur më mirë luftën çlirimtare të Kosovës dhe për ta luftuar Republikën Popullore të Shqipërisë.”<sup>101</sup> Platforma politike e ilegales shprehur përmes kërkesës për Republikën e Kosovës, nuk kishte të bënte asgjë me “shovinizmin kosovar”, ishte doktrinë politike e cila me vete bartte të drejtën e popujve për të udhëhequr me vetveten. Tani Enver Hoxha shprehte dyshimin se në funksionin e kujt do të ishte republika e Kosovës dhe se cilit spektër politik do t'i përkiste dhe a do të mund të bëhej kjo vatër për ta sfiduar regjimin e tij. Ja se si shprehej ai për këtë çështje: “Kjo e ashtuquajtur Republikë e jashtme shqiptare, e kurditur nga titistët mund të bëhet qendër e reaksionit kosovar dhe e të arratisurve fashistë e kriminelë luftime shqiptarë që gjinden në Evropë e në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kurth nuk duhet të bien shqiptarët e Kosovës. Ata duhet ta luftojnë këtë manovër të ndyrë të titistëve të cilët kanë mundësi ta luajnë këtë letër.”<sup>102</sup>

Nga dokumentet arkivore, posaçërisht nga ato të hapura gjatë viteve '90, shohim se është biseduar në qarqet politike ruse për përdorimin e krizave të brendshme në vende të ndryshme të Ballkanit për rrëzimin nga pushteti të kundërshtarëve politikë<sup>103</sup>. Prandaj, gjetja e arsytimit se mund të krijohet ndonjë republikë e ashtuquajtur reaksionare dhe borgjeze apo një republikë, që do të rrezikonte Shqipërinë pos që ishte një alibi për arsyetimin e kësaj mosgatishmërie, njëkohësisht ishte edhe shprehje e mbulesës së rrezikut për

<sup>98</sup> AQSH, fondi 14/AP, dosja 6, d. 1, 19.5. 1959.

<sup>99</sup> Lidhur me këtë Vladimir Dedijer thotë “se qeveria sovjetike shpeshherë informacionet që i posedonte, të njëjtat, e ndonjëherë edhe me përmbajtje kundërtëse, ia jepte Shqipërisë. Sipas Dedijerit, Stalini luante lojëra të mëdha politike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, edhe për çështjen e dy divizione ushtarake të Jugosllavisë në Shqipëri në vitin 1948.” (Vladimir Dedijer, *Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare 1939-1948*. Tiranë: Meduar, 2005, 933; shih edhe: Rossijski *Gosudarestvenij Arhiv Socialno Politiceskoj Istoriji*. Dokumente të pabotuara, regjistrimi i bisedës së gjeneralisimit J.V. Stalin me mareshalin Tito, më 27 maj 1946, 20-23). Po ashtu në ditarin e Enver Hoxhës, rreth lojërave politike të Bashkimit Sovjetik, thuhet se përmes përfaqësuesit çekoslovak në Tiranë, qeveria sovjetike, kishte paralajmëruar qeverinë shqiptare se grekët ishin duke bërë gati të sulmonin Shqipërinë. (E. Hoxha, *vep. e cit.*, 513).

<sup>100</sup> Enver Hoxha, *vep. e cit.*; Enver Hoxha, Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë – Kujtime, (“8 Nëntori”, Tiranë, 1982).

<sup>101</sup> Enver Hoxha Ditari politik për çështje ndërkombëtare 1966-1967 (për përdorim të brendshëm), Tiranë, 147.

<sup>102</sup> Po aty.

<sup>103</sup> United States National Archives (USNA) 767.00/2-262, memorandum i bisedës mes këshilltarit politik të ambasadës jugosllave në SHBA, me përfaqësuesin Departamentit të Shtetit, më 2 shkurt 1962.

pushtetin e tij, meqenëse Enver Hoxha pothuajse në mënyrë konstante është shprehur se e donte një Kosovë ideologjikisht socialiste dhe nëse ajo nuk do të ishte e tillë me të vërtetë mund ta rrezikonte Shqipërinë socialiste, në shumë drejtime. Kështu, sipas tij rrjedhë se një Kosovë me ideologji të njëjtë me Shqipërinë do të ishte shumë më e pranueshme për të. Në të kundërtën një Kosovë kapitaliste, në të vërtetë do ta rrezikonte pushtetin e Enver Hoxhës dhe të udhëheqësve të tjerë shqiptarë, e në këtë drejtim edhe sigurinë e shtetit.

Teorinë politike të internacionales komuniste se përmes konceptit të një revolucioni marksist-leninist, do të zgjidheshin edhe çështjet nacionale, e shfrytëzonte edhe Enver Hoxha, në qasjen e tij ndaj çështjes së shqiptarëve nën Jugosllavi. Përjasja e Enver Hoxhës për rrëzimin e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe udhëheqësit të saj Titos nga pushteti dhe për të ngritur në Kosovë struktura komuniste si në Shqipëri, ishte në fakt një dëshirë për t'i parë shqiptarët e bashkuar, pos të tjerash edhe ideologjikisht. Kjo, faktikisht ishte e pamundur të realizohej, jo vetëm për shkak të prestigjit që në njëfarë mase e kishte siguruar Jugosllavia në atë periudhë në botën politike perëndimore, por edhe për faktin se një komunizëm ideologjikisht intolerant si ai në Shqipërisë ishte i papranueshëm, madje edhe për vetë botën socialiste të Evropës Lindore. Jugosllavia në atë kohë në mbarim të viteve '60 dhe në fillim të atyre '70, kishte tejkaluar kundërthëniet me

Bashkimin Sovjetik, kishte arritur sukses në marrjen e ndihmave të mëdha nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga disa vende evropiane, ishte bërë vendi i cili mori shumë kredi nga institucionet ndërkombëtare financiare. Ishte një periudhë kur vetë komunizmi kishte filluar ta humbte hapin në krahasim vendet e Evropës Perëndimore dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj, të prisje që zgjidhja e çështjes nacionale të shqiptarëve nën Jugosllavi, të bëhej përmes ndryshimeve të thella ideologjike në spektrin politik jugosllav ishte më shumë një fatamorganë politike.

Mirëpo, kishte edhe opinione të tilla që luftën ideologjike të Enver Hoxhës e shikonin nga një prizëm tjetër, duke theksuar se Enver Hoxha ishte një nacionalist, por që përdorte luftën ideologjike për t'i ngritur në një shkallë më të lartë ndjenjat kombëtare të bashkëkombësve të tij. Kështu në artikullin "Boshti i çuditshëm Pekin-Tiranë", të botuar në "The New Leader", më 6 gusht 1962, P. Moulton Mayer, vë gishtin në pikën e dobët kur thotë se grindja e tanishme ndërmjet Tiranës dhe Beogradit, megjithëse duket si ideologjike, është në thelb nacionaliste. Është absurde të besohet se Enver Hoxha me kolegët e vet lufton vetëm për marksizëm-leninizëm sikur kjo të ishte një diçka sekrete... Kur Shqipëria ishte faktikisht një protektorat jugosllav, Tirana kishte ulur ndjenjat e saj të flakta nacionaliste aq shumë sa kur ky korrespondent pyeti ministrin e sotëm të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Behar Shtyllën, i cili për fat tashti ishte në Nju Jork duke marrë pjesë në sesionin e OKB-së, mbi fatin e Kosovës dhe se ç'mund të këshillohej për ngritjen e kësaj çështjeje, zoti Shtylla u përgjigj se shqiptarët dhe Jugosllavia ishin miq dhe se Kosova do të bashkohej me Shqipërinë me rrugë paqësore.<sup>104</sup>

#### *Qëndrimet e Enver Hoxhës dhe Fadil Hoxhës rreth çështjes së Kosovës në vitet '70*

Në qoftë se ndalemi te disa nga dokumentet e asaj kohe, nga të cilat duhet të disa bëjmë analiza të kujdesshme dhe me mënyra krahasuese, mund të konstatojmë se në disa raste kemi përafrimin e qëndrimeve të politikës zyrtare të Enver Hoxhës me politikën zyrtare të komunistëve jugosllavë dhe vartësve të tyre në Kosovë. Në fillim të viteve '70 ishte dukur tendenca e forcimit të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në të njëjtën Shqipëria bënte përpjekje që me çdo kushte përmirësonte marrëdhëniet me Greqinë dhe me Turqinë, vende këto të cilat ishin anëtare të paktit NATO<sup>105</sup>.

Pas ngjarjeve të vitit 1968 në Çekosllovakia dhe pas deklaratës së Brezhnjevrit për "sovrانيتetin e kufizuar", Shqipëria e ndjente veten të rrezikuar nga mundësia e ndërhyrjes së jashtme në Shqipëri. Në këto zhvillime diplomacia e shtetit shqiptar përmes ambasadës së saj në Beograd u mundua të tregojë shumë e kujdesshme për zhvillimin e ngjarjeve që ndodhnin në Kosovë, posaçërisht kur këto zhvillime kishin marrë një trend të shpejtë të zhvillimit të tyre. Demonstratat e vitit 1968 e kishin shtyrë Enver Hoxhën dhe diplomacinë e tij të kuptonte se ç'po ndodhte në Kosovë dhe se cili ishte qëndrimi i politikës kosovare në këtë drejtim dhe shumë çështje të tjera.

Më 19. 9. 1970 Enver Hoxha organizoi një takim me Lik Seitin, të ngarkuarin me punë të RPSH-së në Jugosllavi, në prani të Ramiz Alisë, me kërkesën e të ngarkuarit për përgjigjen që duhet dhënë Fadil Hoxhës.

I ngarkuari i shtetit shqiptar ishte takuar me Fadil Hoxhën dhe kishin biseduar për zhvillimet politike që kishin ndodhur në federatën jugosllave dhe në Kosovë. Sipas Lik Seitit "tek Fadil Hoxha ekzistonin ndjenja shqiptarizmi. Fadil Hoxha ishte shumë i shqetësuar për vrullin e rinisë, i cili nuk mund të përmbahej dhe i

<sup>104</sup> AMPJ, Viti 1962, Dosja B/7, nr. 723.

<sup>105</sup> Beqir Meta, vep. e cit., 207-272.



cili manifestonte në një masë të gjerë e të hapur dashurinë për Shqipërinë dhe Enver Hoxhën.”<sup>106</sup> Në këto vite lëvizja ilegale dhe forcat progresiste intelektuale kishin arritur të fuqizonin ndjenjën patriotike ndaj Shqipërisë dhe kulturës kombëtare shqiptare, duke e krijuar një filozofi nacionaliste për të drejtat e popullit shqiptar nën Jugosllavi, që të jenë të lirë e të barabartë me popujt e tjerë dhe me qytetërimin evropian. Kjo lëvizje i theu të gjitha koniunkturat e sinkronizuara politike të udhëheqësve të dy vendeve. Fadil Hoxha i kishte thënë Lik Seitit se “e kishte të vështirë të frenonte këtë vrull se ai nuk ishte kundër dashurisë ndaj Enverit dhe mbajtjes së fotografisë së tij nga ana e rinisë kosovare, përkundrazi ai ishte i pari që e donte Enver Hoxhën më shumë se kushdo tjetër, por sepse kjo i prishte punë. Gjatë luftës kur fotografia e Enver Hoxhës kishte filluar të hiqej ai e kishte vënë në dijeni vetë Enver Hoxhës dhe e kishte këshilluar që këtë çështje ta ngriste në Komitetit Krahinor të Kosovës.”<sup>107</sup>

Lik Seiti, duke shpjeguar bisedën me Fadil Hoxhën theksonte se ky i fundit i kishte thënë se “në rast të ndonjë agresioni kundër Shqipërisë ai personalisht do të ishte ushtar besnik i Enver Hoxhës dhe se Kosova kurrë nuk do t’i kundërvihet RPSH”<sup>108</sup>. Sipas Lik Seitit, “Fadil Hoxha që në kohën e Rankoviçit kishte bërë përpjekje që Kosova të fitonte autonomi. Kjo ishte edhe arsyeja pse ishte vënë në shënjestër. Në mesin e kundërshtarëve politikë të Fadil Hoxhës ishte edhe Petar Stamboliqi.”<sup>109</sup>

Shqipëria dhe udhëheqja e saj përmes mekanizmave të saj shtetërorë vazhdimisht dëshironte të kuptonte marrëdhëniet mes udhëheqësve kosovarë dhe qëndrimin e tyre ndaj Shqipërisë, si dhe ndaj politikës së Enver Hoxhës në raport me Jugosllavinë dhe Titon. Në këtë rast Enver Hoxha kërkonte informacione të hollësishme për udhëheqësit kosovarë si për: Fadil Hoxhën, Veli Devën, Ali Shukriun etj. Kështu, sipas Lik Seitit, “Fadil Hoxha dhe Veli Deva janë më të mirë, kurse Xhavit Nimani dhe Ali Shukriu janë ndryshe. Kur ishte në fuqi Rankoviçi, Ali Shukriu pozitat i kishte më të forta se Fadili e Veliu.”<sup>110</sup>

Pyetjes së Enver Hoxhës se kush prej udhëheqësve të Kosovës ishin pro rrymës serbomadhe të Rankoviçit, Lik Seiti iu përgjigj: “Dyshime ka për Xhavit Nimanin dhe Ali Shukriun. Madje, Ali Shukriun Titoja e ka aktivizuar shpesh dhe i ka dhënë edhe popullaritet”<sup>111</sup>. Ali Shukriu ka qenë edhe në Shqipëri, ishte njeri i përgatitur për funksionet qeveritare. Atë kohë merrej me ekonominë, sidomos me marrëdhëniet e Jugosllavisë me vendet arabe.”<sup>112</sup>

Pas fjalimit të Enver Hoxhës në Tropojë Xhavit Nimani dhe Ali Shukriu e përshëndetën më shumë se më parë të ngarkuarin e Shqipërisë me punë në Beograd, duke dhënë shenja afrimi. Të njëjtin qëndrim mbante Ymer Pula, i cili nga të dhënat e agjencurës dilte person më pozitiv”<sup>113</sup>.

Pyetjes së Enver Hoxhës se si qëndron Nikeziqi me shqiptarët, Lik Seiti i përgjigjet se “kemi dëgjuar se i përkrah se ka dhënë mjaft këshilla kur ka qenë në Kosovë.”<sup>114</sup> Fadil Hoxha kërkonte të dinte mendimin e Enver Hoxhës mbi lëvizjen e Rezak Shalës i cili ishte për krijimin republikës shqiptare në Jugosllavi. “Fadil Hoxha ishte kundër një gjëje të tillë mbasi ai njihte vetëm republikën Popullore të Shqipërisë. Ai ishte për një autonomi të plotë të Kosovës. Rezak Shala ishte prokuror, të cilin, pas orvatjes që bëri për krijimin e Republikës, e kishin hequr.”<sup>115</sup>

Enver Hoxha ishte i shqetësuar që Fadil Hoxha, pyeste nga vetja e vet apo me dijen e udhëheqësve jugosllavë. Sipas Lik Seitit ishte në dijeni me udhëheqjen mbasi Fadil Hoxha kishte vënë theksin shumë tek Titoja, kur donte të tregonte sesa shumë interesohej ky dhe si na ka këshilluar vazhdimisht që ta donim Shqipërinë dhe Enver Hoxhën, për arsye se atë e do një popull i tërë dhe tërë autoriteti i RPSHsë është rritur në botë”<sup>116</sup>. Dëshira e Fadil Hoxhës ishte që legatat e dy vendeve të ngriteshin në rang ambasdash. Megjithëse kishte edhe kundërshtarë serbomëdhenj që nuk donin një gjë të tillë”<sup>117</sup>.

Enver Hoxha u interesua nëse Fadili i thoshte këto me bindje apo me gjysmë zëri. Lik Seiti iu përgjigj se “për Titon dhe vijën e tij fliste me entuziazëm, mbase ai i favorizon kosovarët, kurse për Rankoviçin fliste me urrejtje.”<sup>118</sup>

<sup>106</sup> AQSH, 10/ Ap, viti 1970-1971, dosja nr. 387/1, 1.

<sup>107</sup> Po aty, 1-2.

<sup>108</sup> Po aty.

<sup>109</sup> Po aty.

<sup>110</sup> Po aty, 3.

<sup>111</sup> Po aty, 1, 3

<sup>112</sup> Po aty, 3

<sup>113</sup> Po aty, 6.

<sup>114</sup> Po aty, 4

<sup>115</sup> Po aty.

<sup>116</sup> Po aty, 5-6.

<sup>117</sup> Po aty, 6.

<sup>118</sup> Po aty, 6.

Pyetjes së Enver Hoxhës se a do populli Fadil Hoxhën, Lik Seiti iu përgjigj: “E do dhe tek ai duket se ka besim më shumë se tek cili do tjetër nga maskarenjtë e kalibrit të tij. Njerëzit për të flasin më mirë, qarkullojnë fjalë se ai e ka qenë kundër largimit të shqiptarëve jashtë Jugosllavisë.”<sup>119</sup>

Enver Hoxha ishte i interesuar për kthimin e shqiptarëve nga Turqia. Kur mësoi se ishin kthyer 3-4 veta ai porositi të ngarkuarin e shtetit shqiptar që të bënte të ditur politikën e qeverisë për kthimin e emigrantëve në shtëpitë e tyre.<sup>120</sup>

Enver Hoxha nuk dëshironte t'i kthente përgjigje me shkrim Fadil Hoxhës, ndonëse i kishte shkruar një letër. Ai ia jep Lik Seiti që ta mësonte përmendësh e t'i përgjigjej gojarisht mbase ai me shokë nuk ishin të sigurt.<sup>121</sup> Përgjigja ishte e dyfishtë një për Fadilin dhe një për Titon, mbasi Fadili ishte njeri i Titos.<sup>122</sup>

Enver Hoxha e porosit Lik Seitin që mes të tjerash t'i thotë këto fjalë Fadil Hoxhës: “Shoku Enver më porositi t’ju sjell të falat e tij dhe t’ju përsëndes për ndjenjat pastra patriotike, që janë karakteristike për shqiptarët, qofshin këta qytetarë të RPSH-së, qofshin të Kosovës. Ai ishte shumë i prekur për gatishmërinë tuaj se në rast rreziku për RPSH-n, sepse qëndrimi juaj është në vazhden e traditave luftarake të popullit të Kosovës.”<sup>123</sup>

Duke bërë krahasimin e vlerësimeve, gjatë bisedës me ato që kishte shkruar, del se përgjigja ishte diplomatike. Ndryshimet në Kosovë, të drejtat e fituara në çështjen e gjuhës të arsimit, të administrimit etj. Udhëheqja shqiptare i vlerëson si fitore kundër korrenteve antishqiptare e rankoviqiane, serbe e malazeze. Enver Hoxha mbështet qëndrimin e Fadil Hoxhës për të mos pranuar krijimin e një republike të dytë shqiptare, si një qëndrim i drejtë, madje deklaronte se do të luftonte me të gjitha forcat për një qëndrim tjetër.<sup>124</sup>

Po kështu Enver Hoxha ishte i mendimit se duhet punuar për formimin e autonomisë së Kosovës, një autonomi të plotë si në pushtet, në ekonomi, në arsim e në kulturë, në përgatitjen e kuadrave dhe sigurimin e shtetit etj.<sup>125</sup>

Qeveria shqiptare mendon se kjo kërkesë është në përputhje me politikën nacionale dhe nga ana tjetër është një entitet kombëtar i madh, i njohur nga vetë kushtetuta jugosllave, me këtë kërkesë luftohen shovinistët serbë.<sup>126</sup> Po kjo nuk është e gjitha. Kishte edhe shumë të drejta të fushave të tjera që duhet të fitoni kosovarët.<sup>127</sup>

Shtendosjen e marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi Enver Hoxha me çdo kusht dëshironte ta ruante, sepse ai e shihte mundësinë që përmes kësaj forme të ndikojë në të gjitha zhvillimet politike në Kosovë. Nga raportet e acaruar ai tani e kuptonte se nuk mund të influenconte me politikën e tij në çështjen e Kosovës. Prandaj ai theksonte se “Në bashkëpunim me Beogradin qeverisa shqiptare do ta zhvillonte Kosovën. Ajo do të ndihmonte Kosovën në të gjitha drejtimet, veçanërisht në zhvillimin e arsimit, me përgatitjen e kuadrave me tekstet, si për Universitetin edhe për shkollat e tjera, shkëmbim përvojash, vizitash etj. Qeveria shqiptare me kënaqësi do të plotësonte të gjitha kërkesat kosovare.”<sup>128</sup> Lidhur me marrëdhëniet me federatën jugosllave udhëheqja më e lartë partiake dalloj dy qëndrime krejt të kundërta.

“Ju mund të keni pikëpamjen tuaj, por për ne Tito është antimarxist. Megjithëkëtë ne ju themi që në këto konuinkutura, nuk bëni keq që mbështeteni tek Titoja, sepse ju lehtësoi disi vuajtjet. Por ky qëndrim i Titos ndaj Kosovës sipas pikëpamjes sonë, nuk diktohej nga dashuria ai diktohet nga rrethanat që u krijuan, në të cilat çështje shtrohej: o t’ju ketë armiq, ose t’ju ketë miq. T’ju armiqësoj është e rrezikshme për të. Prandaj do që t’ju ketë miq, gjë që ka rëndësi edhe në luftën e Titos kundër rankoviqianëve.”<sup>129</sup>

Duke parë këto rrethana udhëheqja jugosllave kërkonte të zhvillonte marrëdhënie me shtetin shqiptar. Gjithashtu, ajo do të tregojë se “Shqipëria socialiste ndryshoi vijën e ngjyrën, se titizmi paska pasur të drejtë në qëndrimin e tij. Shqipëria nuk do t’i japë udhëheqjes jugosllave këtë kapital politik.”<sup>130</sup>

Marrëdhëniet me federatën jugosllave do të vinin duke u përmirësuar në rrugë shtetërore. Qeveria shqiptare po e studion çështjen e shkëmbimit të ambasadorëve, por “udhëheqja jugosllave duhet të dijë që ka

<sup>119</sup> Po aty, 7.

<sup>120</sup> Po aty, 7.

<sup>121</sup> Po aty, 7.

<sup>122</sup> Po aty, 7.

<sup>123</sup> Po aty.

<sup>124</sup> Po aty.

<sup>125</sup> Po aty, 9.

<sup>126</sup> Po aty.

<sup>127</sup> Po aty, 8.

<sup>128</sup> Po aty, 9.

<sup>129</sup> Po aty, 10.

<sup>130</sup> Po aty, 11.

bërë shumë të këqija ndaj RPSH-së dhe shumë të këqija duhet t'i dënojë publikisht që të mund të pastrohet sadopak rruga nga pengesat që ajo vetë i ka krijuar vite me radhë.”<sup>131</sup>

Duke diskutuar qëndrimet politike të Fadil Hoxhës, i cili në këtë kohë reflektonte si udhëheqës i shqiptarëve në Jugosllavi dhe si njeri i afërt i Titos, Enver Hoxha dëshironte të kuptojë dhe të njoftohet mbi qëndrimet e Fadil Hoxhës.

Kështu gjatë analizës së këtij dokumenti kemi afrinë mes qëndrimeve të dy palëve. “Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë sipas udhëheqjes shqiptare do të vijë në situata të tjera. Siç dihet Fadili ishte kundër republikës, megjithatë ai në këtë kohë nuk deklaroi se dëshironte se Kosova të bashkohej me Shqipërinë. Fadili kërkonte vetëm autonomi të plotë dhe në këtë situatë edhe ne jemi dakord me kaq.”<sup>132</sup> Të dy palët, siç shihet ishin dakorduar të ruanin një status quo dhe të bënin ç'ishte e mundur që të largohej sundimi dhe influenca e Serbisë mbi Kosovën. Më tutje, në dokument thuhet: “Qëllimi është që në Kosovë të mos sundojnë serbët. Këta të shkojnë në vendin e vet, kurse me pushtet në Kosovë të sundojnë kosovarët, këta të jenë atje në krye në të gjitha sektorët: në pushtet, në ekonomi, në ushtri, në sigurim. Bile të luftojmë që kudo të fusim njerëz të mirë që kur të vijë momenti të bëhet bashkimi. Çështja duhet bërë, pra dialektikisht, se me dëshirë nuk bëhen këto gjëra.”<sup>133</sup>

### Përfundim

Politika e shtetit shqiptar në fillim të viteve '60 ishte në një situatë të vështirë, posaçërisht pas prishjes së raporteve me BRSS-në. Shqipëria ishte e izoluar politikisht dhe mbështetja e çështjes së Kosovës ishte fokusuar më shumë në vijat ideologjike. Shqipëria kishte shtruar si platformë politike brenda institucioneve të saja shtetërore detyrat për t'u marrë me çështjen e Kosovës. Enver Hoxha, në konceptin e tij politik, zgjidhjen e çështjes së Kosovës e shihte nën dritën refleksioneve ideologjike. Ai llogariste në një koalicion të mundshëm të forcave politike antititiste në gjithë Jugosllavinë. Zhvillimet në Kosovë, kërkesat e vazhdueshme nga lëvizja ilegale drejtuar Shqipërisë për mbështetje të saj, e shtyn politikën shqiptare për t'u marrë me çështjen e Kosovës.

Kjo periudhë karakterizohet nga intensiteti marrëdhënies të PPSH-së me grupet politike shqiptare në emigracion dhe brenda në Kosovë. Në këtë kohë marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë shihen si marrëdhënie në frymën e shtendosjes. Enver Hoxha tentonte t'i shfrytëzonte këto raporte të reja për të influencuar në lëvizjen politike në Kosovë. Ai kritikoi organizimin politik të ilegales në Kosovë nga pozicioni i tij ideologjik, duke dërguar mesazhe për format e reja të veprimt dhe duke kërkuar të heqin dorë nga parullat si “Luftë për t'u bashkuar me Shqipërinë”. Qëndrimi zyrtar i Enver Hoxhës përputhej me qëndrimin politik të funksionarëve shqiptarë të Kosovës në nivelin federativ, rreth ekzistimit të vetëm një republike shqiptare, në këtë rast të Republikës së Shqipërisë dhe sa i përket Republikës së Kosovës të dy palët shpreheshin kundër krijimit të republikës së dytë shqiptare. Enver Hoxha dhe udhëheqja e Kosovës kishin vendosur interesat e tyre përballë interesave të çështjes së Kosovës.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kishin përcjellë me kujdes refleksionet e demonstratave të vitit 1968. Kosova hyri tani në një fazë të re të zhvillimit politik, juridik, ekonomik dhe kulturor. Lëvizja ilegale doli hapur me kërkesën për republikë. Institucionet kosovare mbështetën pozicionin politik të ilegales, në fazën e parë. Shqipëria kishte qëndrim hezitues ndaj kërkesës për Republikën e Kosovës.

Në rrethanat politike të krijuara pas intervenimit të Paktit të Varshavës në Çekosllovakia, Shqipërisë më shumë i shkonin për shtati zhvillimet e ngadalshme për sa i përket statusit juridik të Kosovës në federatën jugosllave.

© DKE 2014

<http://www.southeast-europe.org>  
[dke@southeast-europe.org](mailto:dke@southeast-europe.org)

*Shënim:* të respektuar kërkesë noqëftëse bëni një referim të artikullit ose përmendeni një pjesë të tij, ju lutemi në çoni një e-mail në adresën: [dke@southeast-europe.org](mailto:dke@southeast-europe.org) që të na bëni njoftim. *Ju lumi shënoni artikullin kështu:*

Ethem Çeku: Kosova në shtendosjen e raporteve Shqiptaro-Jugosllave në vitet '60-70. *International Relation Quarterly* (Verë 2014) 19 p. Faleminderit për mirëkuptimin. *Kryedaktori.*

<sup>131</sup> Po aty.

<sup>132</sup> Po aty, 16.

<sup>133</sup> Po aty.